



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË  
REPUBLIC OF KOSOVO  
THE MUNICIPAL ASSEMBLY - MALISHEVE / E-SHAPE JUNA QËSTINE MAUSEVO

Kuvendi Komunal Malishevë

PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 18/12/2024  
PRIMLJENO:  
Nr. No. P.: 02/459

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së -IV- (katër) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë: 30.05.2024 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 23 asamblistë, Kryetari i Komunës Ekrem Kastrati, Drejtorë komunal: Blerim Thaçi, Bashkim Krasniqi, Sylë Dukolli, Valbon Hoti, Avdi Morina, Arbëreshë Krasniqi, përfaqësues nga drejtoria për shërbime publike Fadil Shala, përfaqësuesi nga Kfori dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 4 të rregullt të Kuvendit. Të pranishëm jemi 23 anëtarë të Kuvendit kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë me mbajtje të mbledhjes. Me leje mungon Sadik Vrenezi, Labinot Gashi dhe Zamire Morina.

Para se të fillojmë me rend të ditës a ka dikush për diskutim jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Dua ta ngris një shqetësim, ne si anëtarë të Kuvendit ka dy muaj që nuk kemi mbajtur seancë në kuvend dhe kjo është shqetësuese. Munden me mungu një anëtarë ose dy por jo pjesa dërrmuese e Kuvendit, sepse këtu jemi duke i përfaqësuar qytetarët. Është mirë që seancat e Kuvendit të jenë së paku një herë në muaj, për arsye se secili muaj i ka specifikat e veta të rendit të ditës dhe nuk mundemi në këtë rend të ditës të trajtohen mbi 30 pika. Besoj që presim një sqarim përse ka ndodhë kjo.

Dalim te pikat që janë në interes të qytetarëve te mos pagesa e lehonave. Kryetar, ka mbi një vit që nuk janë duke u ekzekutuar pagesat, çka është problemi me këto?

Qështja tjetër kontrata që e keni pasur me Kosova Med-in që kanë qenë disa punëtor duke punuar aty, kamë informacione që i është shkëputur kontrata një muaj para kohe kishë me vetë dëshirë, pas asaj me funksionalizuar një tender përmes prokurimit me i rikthyer prapë në punë. Dhe pagesat e këtyre më duket qe dy muaj nuk janë bërë. Çka është problemi?

Pasi e kemi Drejtorin e Urbanizmit këtu, kemi disa ditë në qendër të qytetit te parku punimet kanë qenë të ndalura Drejtor, jo në atë intensitetin qysh duhet të punohet në rrugë. Më duket shumë ngadalë kanë shkuar ku është problemi?

Rruga "Adem Jashari" Halili e dinë dhe nga mandati i kaluar është pa kanalizim e gjithë ajo pjesë, unë e di që ka kaluar disa herë në projekt buxhete dhe prapë ata njerëz janë pa kanalizim. Kryetar, është mirë me i planifikuar kur do të rregullohet ajo.

Spërkatja e rriqrave i kemi disa informacione nga terreni që nuk janë duke u bërë mirë sepse nuk ka spërkatje që gjuajnë në mënyrë të përgjysmuar por vetëm e lëshon ujin edhe e përfundon punën dhe del nga aty. Mirë është me shikuar dhe këtë pjesë a janë duke u spërkat rriqrat mirë. Te mbeturinat e kam bërë një reagim publik, jo politik por reagim publik. Disa deponi janë ende të pa pastruara, Kryetar mundësisht është mirë të merren masat sidomos pjesa e cila del te autostrada rruga e Kombit, ajo pjesë është shumë keq.

Dëmtimi i rrugëve lokale ka dëmtime të ashpëra në rrugë ndoshta dhe prej individëve ndoshta nga Kompanit. Qytetarët detyrohen ti vendosin beton gropave të cilat janë shkaktuar në fshatra. Kemi diskutuar gjërë e gjatë ka kontratë për mirëmbajtje të rrugëve lokale por asnjëherë asnjë veprim, unë të paktën ato që i vizitojë nuk kamë parë që janë rregulluar. Këto ishin disa pika të cilat i kamë pas, për pjesën tjetër do të kyqem me kohën faleminderit.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!**

**Alban Kastrati (anëtar nga PDK):** E cekti dhe kolegu im Nebihu, me të vërtetë është shumë shqetësuese pas dy muajve sot takohemi këtu me mbajt seancën.

Një fakt tjetër shqetësues disa vizita të cilat i keni bërë gjëja që për puntori në Shqipëri, nuk kanë të bëjnë me puntori kjo më shumë i ngjason një fushate ajo nuk ka të bëjë me zyrtar Komunal por ka të bëjë me aktivista të partisë NISMA. Sigurisht kjo ka pasur një kosto akomodimi në ato hotele ka një kosto, të njëjtit sigurisht kanë shkuar dhe në mërgat po ashtu me taksa të qytetarëve, kjo nuk është për mburrje dhe është fyese për qytetarët e Komunës së Malishevës.

I shoh zotimet që janë bërë për rregullimin e sallës nuk është bërë asnjë hap, nuk e di qfarë duhet të bëjmë diqka tjetër ne anëtarët e kuvendit. Ne i kemi paraqit kërkesat e tona ju i keni dhënë premtimet që do ta rregulloni dhe ende nuk keni marrë asnjë hap.

Në qendrën e mjeksisë familjare mungojn gjërat elementare, mungojn kanilat, gjilpërat për me marrë një inekSION ose infuzion duhet me shku në barnatore me i ble, që është diqka shumë elementare. Dua të di a ka ndonjë listë dhe cilat ilaqe ju ofrohen qytetarëve?

Sa mjete ndahen për këto ilaqe që janë shumë të domosdoshme?

E kemi Urimin këtu që ndoshta mundet me na tregu se çka ju ofrohet qytetarëve të Komunës së Malishevës, konkretisht pacientave në qendrën e mjeksisë familjare?

Pyetje tjetër kam, Kompania e cila e ka rregulluar shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike e ka bërë një punë, mirëpo i ka lënë në gjysmë punimet kanalizimet, premjet e asfaltit i ka bërë në mënyrë më të keqe të mundshme. I ka lënë të gjitha ato mbeturina dhe aty ku e ka mbuluar e ka bërë në mënyrë më të keqe. Është mirë Kryetar që këto gjëra, këto punime me caktuar nga një mbikqyrës me shku me parametra qysh e kërkon standarti.

E kam një pyetje për Drejtorin e Administratës, kisha kërkuar me na sjellë listën e punonjësve konsulent. Cili është numri i tyre dhe pozitat e tyre?

Sa paguhen ata punëtor?

Sepse ne e dimë që ata paguhen nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve, këtë kisha kërkuar me pas një listë dhe me ditë saktë sa punonjës janë me këtë status, dhe sa është kostoja që paguhen këta punonjës?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!**

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Unë i kam disa pyetje për Kryetarin dhe Drejtor që janë të pranishëm sot këtu.

Kryetar, nëse mundesh me na dhënë një sqarim deri ku kemi arrit me regjistrimin civil, ka përfunduar si proces dhe si Komunë a ka shkuar në mënyrën e duhur dhe a jemi në ato shifrat e 2011 apo ka rënje të banorëve apo ka ngritje?

Qështja e dytë e kamë parë në bulevardin "Ibrahim Mazreku" Drejtor drunjët që janë mbjell aty, i kam parë që një numër i madh prej tyre janë tha. Kompania që e ka përfunduar këtë punë a ka një kontratë një periudhë të caktuar kohore ku i ujit dhe i ndërron nëse thahet dhe a keni marrë masa në këtë drejtim?

Qështja tjetër që ka të bëjë me veb faqen e Komunës në shumicën e kohës nuk është funksionale, nuk përditësohet me informacione qoftë për konkurse, për njoftime, për aktivitete të Komunës. Sa di unë Komuna ka një kontrat me kompanin Hidroregjionin për pagesën në vlerë afër 30.000.00E për pompat e ujit, sa i përket pagesës së Hidroregjionit e ka përfunduar pompat janë blerë por nuk po vendosen për arsye se Komuna nuk e ka përfunduar një obligim prej 30.000.00E. Nëse është e vërtet përse nuk po ekzekutohet ajo pagesë?

Drejtoresha e Arsimit nuk qenka këtu në Gjimnazin "Jeta e re" në Therand kam informacion mbi 30 nxënës nga Komuna e Malishevës përkatësisht fshatit Banjë, Bellanicë, Temeqinë dhe fshatrat tjera shkojnë në shkollë në Therand. Nuk jam lokalist nëse është e vërtet përse po ndodhë kjo, përse nuk po i zgjedhin shkollat tona përse po ndodhë si fenomen?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** Përshëndetje për të gjithë!

E kam një shqetësim të cilin e cekën dhe kolegët për problemet në infrastrukturën në rrugët lokale, po ashtu për pluhurin i cili është shumë aktiv muajve që i kemi kaluar në qytetin e Malishevës, ndoshta është mirë me dalë inspektorët dhe me ju dhënë vërejtje kompanive të cilët punojnë. Është mirë me u marrë me këtë pjesë.

Ndriqimi publik tash e disa seanca jemi duke e cekur që është në gjendje jo të mirë, është mirë me i rregulluar sa më shpejtë këto probleme.

Një shqetësim tjetër ka të bëjë me arsimin, këtë vit ende nuk është bërë shpallja e bursave për student është mirë me ditë a do të realizohen dhe kur do të bëhen këto?

Një shqetësim tjetër është lëvizja e Drejtorëve Komunal me vetura zyrtare, përkatësisht Drejtori i administratës publike dhe drejtorët e tjerë jashtë orarit të punës çka janë duke punuar apo qfarë janë duke bërë?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** I nderuar z.Dukolli siç je në dijeni dit më parë ka pasur një breshër të madh në Komunën e Malishevës ku kanë pasur dëme në bujqësi, sidomos në fshatrat që gjinden në bjeshkë. Dua ti cekë në fshatin Ngucat ka plantacione në qershi, kumbull, shalqi ku pas këtyre reshjeve janë dëmtuar rënd duke lënë humbje të konsiderueshme për shumë familje bujqësore. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme dhe të efekshme. Dua të kërkoj nga ju që ti vlerësoni këto dëme dhe të i dilni në ndihmë këtyre fermerëve.

Kur jemi te fshati Ngucat dua ta cekë aktivizmin qytetar të banorëve të këti fshati ku muaji Maj

është dhe muaji i aktiviteteve rinore kulturore dhe sportive në këtë vend. Veqoj të cekim organizimin e turnirit tradicional Ngucati nderon Dëshmorët i cili mblodhi rreth 70 ekipe nga mbarë Kosova. I nderuari Kryetar këto organizime duhet të përkrahen nga ne si institucion dhe sigurisht që këto organizime ndikojnë në fuqizimin dhe organizimin e të rinjëve.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!**

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Kolegët e ngritën një shqetësim që e kemi pasur të gjithë si asambleistë, në muajin që lam pas ne nuk kemi mbajtur nuk e di arsyen përse nuk kemi mbajtur seancë, por e di sigurt që kjo mos mbajtje e seancës nuk mund të lidhet me aktivitete politike që i ka bërë subjekti im politik NISMA Socialdemokrate, sepse grupi i asambleistëve të Nismës kanë qenë të gatshëm në secilën ditë të muajit që lamë pas të mbajnë seancë. Kështu që aktivitetet politike tona me punën tonë që është bërë në kuvend nuk kanë rënë ndesh dhe nuk kanë rënë në kontradit. Secili subjekt politik ka të drejt me i bërë aktivitetet e tyre ku dhe si të dojë, secili subjekt politik është organizat e pavarur ku organet e ati subjekti politik marrin vendime se si me i organizu punëtorit e tyre dhe ku me i organizu në ndonjë pishin apo në det ku të donë subjekti politik. Nuk ka të drejt askush të përzihet aq më tepër me dalë me thënë keni bërë pushime dhe aktivitete me taksa të qytetarëve, thënë nga gjuha e një juristi. Kur thua ke bërë aktivitet politik me taksa të qytetarëve nga këndvështrimi juridik ti paraprakisht vetëm e ke fakti atë punë me dokumente dhe pastaj ke dalë me thënë atë fjalë. Kërkoj nga ti me i sjell dëshmit e tua se si NISMA Socialdemokrate paska bërë aktivitet politik me taksa të qytetarëve. Nëse ti e dëshmon këtë ka me ardhë me u ulë mbrapa teje në grupin tënd, por nuk mundesh me dëshmu. Mundesh me ngre dyshime ose hipoteza është krejtësisht legjitime, pastaj kur i merr me i vërtetu ato hipoteza në bazë të fakteve dalin se cila është e vërteta e asaj pune. Por me dalë me thënë konkluzione këtu është juridikisht jo korrekte dhe politikisht e pa moralshme.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!**

**Driton Kastrati (anëtar nga LDK):** Unë do të ndalem te një problematik e punimeve që po bëhen në Malishevë rreth infrastrukturës. Punimet të cilat po bëhen në qytet patjetër që janë të mirëseardhura, por ajo që është shqetësuese është se nuk janë ndërmarr masa profesionale dhe adekuate nga institucionet komunale në drejtim të lehtësimit të punës së punimeve rreth investimeve që po ndodhin. Problematika kryesore është në mos funksionalizimin e rrugëve alternative që e mundësojnë lëvizjen e qytetarëve në Malishevë dhe fshatra. Është shqetësuese se dhe rrugët të cilat janë alternative nuk mirëmbahen dhe nuk janë në gjendje shumë të keqe, ka pengesa të forta sidomos duke ardh prej gjykatës është një shtyllë elektrike në mes të rrugës që e pengon lëvizjen e lirë në të dy drejtimet. Jemi dëshmitar që po bëhen shumë dëme të veturave dhe po ju shkakton shumë dëme dhe bizneseve të cilat kanë rënie të fitimeve dhe shitjetve të tyre. Kërkoj nga institucionet përgjegjëse ti ndërmarrin veprimet e nevojshme në këtë aspekt.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!**

**Agnesa Kastrati (anëtare nga VV):** Unë e kam vetëm një qështje, pas rasteve të muajve të fundit në Kosovë ose vrasjen e grave dhe dhunës ndaj grave, Komiteti ndërministror që përbëhet prej prokurorisë, gjykatave dhe ministrisë së drejtësisë ka dalë me disa rekomandime që janë të bazuara dhe në strategjinë kombëtare që janë veprime që do të duhej të i ndërmer Komuna. Sa

kam informacione Ministria e Drejtësis ato rekomandime i ka dërgu te Kryetari, janë 4 rekomandime të cilat unë po i cekim e para është: Të ngritet niveli i sigurës në qendrat për punë sociale, të paisen me detector sigurie qendrat për punë sociale, të mbështeten për pavarësim ekonomik viktimat e dhunës në familje, të shtohen kapacitete njerzore dhe profesionale në QPS bazuar në analizen të cilën e ka bërë në vitin e kaluar Ministria e Drejtësisë. Meqenëse këto janë obligime të cilat dalin dhe prej ligjit për barazi gjinore edhe prej strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje që obligohen Komunitet me i ndërmarr këto veprime, lidhur me këto rekomandime a ka ndërmarr ndonjë hap Komuna e Malishevës.

Po e ripërsëris pyetjen në vitin e kaluar Kuvendi Komunal e ka miratuar mbështetjen financiare për strehimoren që strehohen viktimat e dhunës në familje nga Malisheva, a është ekzekutuar ai vendim? A i kanë dalur mjetet strehimores së viktimave të dhunës në Gjakovë?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

**Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK):** Kam një qështje për të ngritur për Drejtoreshën e Arsimit e cila është këtu, kërkoj nga Drejtoresha që të ndalohet vaksinimi i fëmijëve në shkolla pa dijenin e prindërve. Edhe një herë tjetër e kam ngritur këtë qështje këtu, e falenderoj Drejtoreshën e shkollës 12 Prilli në Vërmicë e cila nuk ka lejuar të vaksinohen fëmijët pa dijeni të prindërve, pra na ka lajmëruar në telefon që fëmijët e vitit 2012 duhet të vaksinohen.

Qështja e rrymës, është duke u punuar në këtë qështje, por a do të përfundoj kjo ndërprerje e rrymës deri në datën 15 Qershor, sepse tani më e dimë që është koha e gurbetgjive dhe mos të i mërzhisim me këtë ndërprerje të energjisë elektrike që e kemi nga ora 09:00 deri në ora 16:00.

Një pyetje për Drejtorin Avdi a je duke dalur në fshatra a jo?

Kryetar, kemi nevojë për rrugë në fshatra, e dimë që investimi është duke shkuar në qendër por mos të i lëjm anash dhe rrugët në fshatra sepse kemi nevojë të paktën të mirëmbahen. Nuk e di ku po shkojnë ato shpenzime mirëmbajtje e rrugëve ku rrugët nuk janë duke u mirëmbajtur.

Qështja e ujit në disa fshatra kur do të merren masa që dhe ne të kemi ujë të mjaftueshëm?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Urim Thaqi!

**Urim Thaqi (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Unë dua të lidhem me Albanin te lista esenciale. Këtë listë e furnizon Ministria e Shëndetësisë, për arsye të mungesës së furnizimit nga Ministria e Shëndetësis, Kryetari i Komunës e ka bërë një kontrat shtes për listë esenciale për furnizim. Mungesa e furnizimit të barnave nuk është problem vetëm në Malishevë është problem në nivel vendi. Shërbimet të cilat kryhen në Malishevë janë shërbimi i urgjencës, shërbimi i mjekësis familjare, shërbimi specialistik, shërbime gjinekologjike, një gjë e mrekullueshme që e ka Komuna e Malishevës është shërbimi i vizitave në shtëpi rasteve të ndishme të pa lëvizshëm. Që nga fillimin në asamble në shtëpin e shëndetit është bërë një mrekulli, është bërë një staf, bëhen rreth 300,000.00 vizita në ditë nuk kamë dëgjuar asnjëher duke bërë lavdatë për këtë pjesë. Unë e falenderoj z.Kastratin, asambleistët dhe të gjithë Drejtorët për kontributin të cilin kanë dhënë në këtë pjesë. Në seancën e kaluar kamë qenë jashtë fatëkeqësishtë dhe trajtimin e një rasti e bërë shumë të thjeshtë nuk ja kanë dhënë një gjilpër në krah dhe e kemi dërgu në Prishtinë, mjeku e bënë konsultimin e rastit Alban nëse është një rast i cili duhet me bërë tranzitor në Prishtinë, jo ne sepse unë jam vetëm infermier. Nuk është e lehtë janë disa procedura, Alban ke qenë shumë kritik dhe për laboratorin i cili mundem me thënë që është në nivel Kosove i vetmi

që kryen analiza më shumë është QKMF në Malishevë. Është mirë me ardhë me kry një vizitë dhe me shikuar se qfarë shërbime bëhen, është mirë me marrë një mendim të qytetarëve se sa janë të kënaqur, është mirë me falenderu Kryetarin e Komunës dhe asambleistat dhe të gjithë stafin e QKMF-së në Malishevë për punën të cilën janë duke e bërë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!**

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Dua të i shprehi disa shqetësime e para ka të bëjë me qendrën e mjeksisë, u bënë 3 vite që Drejtori i Shëndetësisë nuk ka ardhur asnjëherë këtu. Në shtëpin e shëndetit e dinë dhe ti Urim, në momentin kur ndalet rryma 2 orë, ju nuk keni ujë dhe 7 orë të tjera, kjo është e tmerrshme këtu duhet Kryetari me ndërmarr iniciativ urgjentisht me bërë zgjidhje. Je duke i bërë lavdata shtëpisë së shëndetit por a jeni duke e mirëmbajt, a funksionojnë tualetet, para dy javesh ka shënuar që tualeti nuk punon.

Kryetar, shqetësimi tjetër është që ke thënë që do të merresh me operatorin i cili e ka bërë deponimin e mbeturinave ilegale, a ke ndërmarr ndonjë hap?

Te pishina e Banjës, Kryetar e kam parë që ja kanë filluar punimet, mandati ka qenë për dy vite dhe ka përfunduar ajo si duket e ka marrë prapë dhe kisha kërkuar me na tregu me qfarë rregullore apo me qfarë procedure ligjore ja keni dhënë, sa ka kushtuar kosto dhe për sa kohë ja keni dhënë?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!**

**Arlind Morina (anëtar nga LDK):** I kam disa probleme që dua të i ngris i pari ka të bëjë me projektin e rrugëve në fshatra përkatësisht në fshatin Astrazup, është viti i 3 i mandatit tonë disa rrugë kanë qenë me u përfunduar më herët por nuk ka ndodhë kjo. Drejtori i Urbanizmit tani vetëm e liroj sallën, pytja ime kishte me qenë ku qëndron problemi?

Bëhet fjalë për rrugën "Isuf Morina" dhe rrugën "Fazli Morina". Rruga "Isuf Morina" të gjithë e dinë të cilët kalojnë andej, kalojnë dhe nxënësit të cilët shkojnë në shkollën "Ganimete Tërbeshi", rruga Fazli Morina është rrugë e cila duhet të rregullohet me urgjencë sepse nga të reshurat të cilat shkaktohen rrezikohet komunikacioni sepse zhavori i gjithi del në rrugën kryesore. Shqetësim tjetër është që rruga Ibrahim Mazreku është rrugë regjionale që nuk i takon Komunës së Malishevës që kalon në mes të fshatit Astrazup është shumë e ngarkuar dhe kamionët të cilët kalojnë andej rrezikojnë jetën e qytetarëve sidomos nxënësve të shkollës tonë. Andaj a duhet ta sjellim të shënuar apo e merrni si kërkes që të ju adresoheni Ministris përkatëse që ti vendosin disa shirita ndërprerës që të ngadalsohet shpejtësia, sepse në të kaluarën kemi pasur raste me fatalitet, ku shpresojmë që mos të ndodhin dhe kërkojmë të ndërhyini.

Qështja tjetër ka të bëjë me ujësjellsin ne e dimë që qytetarët paguajn taksa për mirëmbajtje të kanalizimeve tani sipas disa qytetarëve ka rritje të kësaj që ne paguajm, rritja po ndodh por shërbimi për mirëmbajtje nuk po bëhet nga kompania, ku është problemi?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!**

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Shumë mirë që po keni me i dhënë kritika kryetarit sepse me të vërtet është duke punuar shumë. Një lajm i mirë është që sa po është liruar një nga luftëtarët e UÇK-së nga Komuna e Malishevës që është mbajtur i pafajshëm e kam fjalën për ish Kryetarin e Komunës Isni Kilaj. Uroj që të lirohen të gjithë ata të cilët mbahen atje.

Sa i përket pjesës së aktiviteteve politike më duke Albanit i ka mbetur hatri sepse nuk e ka marrë Bedria, sepse edhe ai ka qenë duke mbajtur fushata politike në mërgatë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo):** Në cilësin e asambleistit komunal pasi që është seanca e parë pas ngjarjes historike dua ta uroj klubin futbollistik FC Malisheva për suksesin e arritur e cila do të luaj në garat në arenën ndërkombëtare. Ne ju urojmë suksese në kualifikime më tutje dhe kalimin në fazën e grupeve në konferenca ligë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Te qështja e Kryetarit, ne nuk flasim për individ ne flasim për pushtetin, ekzekutivin në këtë rast është punë e njollë sepse ai paguhet nga taksat e qytetarëve. Ne nuk i kemi dyshimet absolute sepse kur ti kemi ne e dimë vendin ku me i dërgu për keqëpërdorime, por ne kemi të drejt me ngrit hipoteza se një Kryetar Komune ka shkuar së bashku me njerëzit e ti në deti.

Te qështja e shëndetësisë ne kemi ngrit qështje për politikën qeverisëse brenda nuk kemi akuzuar askënd as stafin, përkundrazi i kemi dhënë lëvdata dhe ne mundemi me i asistu në qka do që kemi mundësi brenda kuvendit, por ne mund të flasim për politikën që ndodhin. Ne mund të flasim për Hajdin Berishën i cili është Drejtor i Shëndetësisë dhe nuk vjen në kuvend asnjëherë, mundë të flasim për punët të cilat bëhen, mund të flasim për stafin që mundet me ndodhë mos me qenë në krye të detyrës. Për këtë arsye kemi nevojë për një sqarim nga Drejtori i Shëndetësisë, sepse ai është i vetmi dhe Kryetari i Komunës që thirret për përgjigjen e pyetjeve tona dhe ankesave tona në drejtim të ekzekutivit.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati (anëtar nga PDK):** Muharrem, dëshirova një sqarim kur jemi jashtë rendit të ditës a duhet me u dhënë replika kur përmendet emri?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Nuk ka nevojë Muharremi lexoje rregulloren të cilën e kom sjellë, Muharremi fol vetëm kur të ja japë fjalën që kam nevojë për interpretim ligjor të kuvendit.

Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Valon, sot i urove mirëseardhje Isni Kilaj dhe e mbështesim dhe ne i urojmë mirëseardhjen dhe kthimin e normalitetit të jetës këtu, por nuk të ka ra ndërmend kur e kanë arrestu me thënë asnjë fjalë sepse atëherë ka qenë në një subjekt tjetër. Faleminderit që ma urove angazhimin tim që nuk e kam ende, më trego me cilin ligj në fuqi ndalohet e drejta e një qytetari me u punësu në një institucion, dhe të ftojë publikisht që i kam ftuar dhe mediat shkoni në ndërmarrje shikoje CV-në e Veton Zogaj shikoj dokumentet dhe nëse kamë bërë ndonjë shkelje përgjigjem kudo.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Veton unë vetëm të urova që je punësuar dhe e ceka që e drejta e punimit është e drejtë themelore e qdo njeriu nuk pyeta përse

je punësuar dhe si je punësuar. E dyta lajm më i mirë është lirimi se burgimi, dhe ka reaguar Kryetari i Komunës në emër të gjithëve në veb faqe të Komunës. Sa i përket subjektit politik nuk është i subjektit tonë politik vetëm ka paraqit përkrahje për partin tonë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Harrova të ceki është për zyrën e Kryesusit, salla duhet me qenë më e pastër dhe simbolet e kuvendit nuk janë prezent po duket më shumë kombëtar, duhet me qenë flamuri i shtetit dhe i Komunës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Kryetar, është mirë me na njoftuar me drejtor të ri sepse para shumë muajve e kam parë një njoftim për një grua që është drejtoreshë që nuk kemi informacion për të.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** E mbylli debatin, pres nga ekzekutivi me ju përgjigj pyetjeve. Urdhëro, Kryetar Ekrem Kastrati!

**Kryetari i Komunës- Ekrem Kastrati:** Përhëndetje për të gjithë!

Do të mundohem të përgjigjem në të gjitha shqetësimet dhe pyetjet e juaja të cilat i shprehët. Mos pagesa e lehonave me drejtorin e financave jemi në fazën finale të evidencave të sakta se kush ka bërë kërkes sepse kjo periudhë është normale me mbajtë evidenca besoj që në muajt e ardhshëm ti marrin pagesat konform rregullorev dhe ligjit.

Kontrata me Kosova Med-in sigurisht që ka ardh drejt fundit dhe ne jemi në fazën e ri tenderimin e këtyre shërbimeve të cilat janë të domosdoshme për Komunën tonë, dhe besoj që me një të ardhme të afërt do të kemi një kontratë të re të cilat do ti shohim dhe elementet negative dhe pozitive në ofrimin e shërbimeve tona shëndetësore.

Ne nuk kemi asnjë kontratë pa paguar është dhe mbikqyrsi i kontratave i cili i sheh se a janë përfunduar të gjitha shërbimet në bazë të asaj që e ka pasqyruar në fakturë.

Punimet në shesh nuk është vetëm shqetësimi i juaj dhe i qytetarëve por dhe i imi, qdo ditë i shikoj ngecjet, punimet dhe dinamiken e këti projekti. Besoni 24 orë merrem me ecurinë e këtyre punimeve të cilat i kemi në shesh, po bëjmë maksimumin që punë kryersi të i përfundoj punimet në bazë të dinamikës dhe kualitetit të parapar në kontrat. Deri më tani e kemi një vonesë dy javore për arsye të kushteve atmosferike dhe për fajin tonë sepse nuk kemi mundur të i dhëjm të dhëna urbanistike punë kryersit për kabllot nëntokësor, për ujrat atmosferike, për kanalizimet për të gjitha këto të cilat i ka kërkuar që mos të i dëmtoj dhe të punojë më shpejtë.

Rruga “Adem Jashari” sigurisht që në periudhën e ardhshme ta përfshijmë në projekte të reja, mos të bëjmë investime kot me hap kanalizime kur ne mendojmë që ajo rrugë duhet të zgjerohet në 4 kursi dhe të ofrojmë mundësi tjera siq është bulevardi “Ibrahim Mazreku”.

Spërkatja e hapsirave ne e kemi themeluar një kontratë dhe jemi në luftimin e etheve hemoragjike krime kongo për çdo vit jemi duke i trajtuar dhe fatmirësisht nuk kemi pasur raste me fatalitet që nga viti 2013. Besoj që deri më tash i kemi trajtuar shumë mirë mirëpo na mungon bashkëpunimi me qeverinë qëndrore sepse atje është i themeluar një ekip ndërministror për trajtimin e këtyre. I kam bërë shkres ministrisë së shëndetësisë që ta thirr këtë grup dhe të i bëjmë hapat e tjerë në luftimin e kësaj epidemie.



Deponit e mbeturinave i kam parë ne e kemi pasur një kontrat dhe është shpenzuar nuk kemi më që të operojmë me atë kontratë, duhet ta fillojmë një procedurë të re të prokurorit prandaj kanë mbetur ato mbeturina ashtu. Besoj që kur ta themelojmë kontratën e re do ti trajtojmë të gjitha ato mbeturina në bazë të ligjeve në fuqi.

Dëmtimet e rrugëve për kundër angazhimeve tona po bëjmë apel të vazhdueshëm që mos të i dëmtojnë pronat shoqërore, asetet tona shoqërore rrugët konkretisht po bëjmë apel të vazhdueshëm dhe kur po kemi takime me Kryetar të fshatrave. Ne po mundohemi që me inspektoriatin të intervenojmë në disa mjedise i kemi disa fletëparaqitje ku janë bërë disa dëmtime.

Udhëtimi jashtë vendit Albani gaboje sepse kjo është iniciativ private partiake, nuk ka të bëjë me fonde publike dhe me i asgjesu. Unë jam Kryetar i Komunës por jam dhe anëtarë i partisë Nisma Socialdemokrate në Malishevë, kam të drejtë me shok, familje me shkuar në deti nuk është qështje me u bërë debat këtu.

Renovimi i sallës, ne e kemi nxerrë një vendim dhe një projekt, Kryesusi e ka dorëzuar, dhe në bazë të atij projekti dhe në bazë të përpjekjeve tona kjo asamble do të ketë një pamje të re. Furnizimi i QKMF-së ne nuk duhet të hedhim akuza të mëdha në këtë institucion sepse me të vërtetë po bëjnë një punë të mirë. Shërbimet të cilat i ofron qendra mjeksisë familjare këtu në Malishevë nuk i ofron Suhareka, Drenasi dhe as Klina besoj që këtë e dini, flas kështu sepse kemi disa fshatra të këtyre Komunave të cilët vijnë dhe kontrollohen këtu. Ndoshta ka shkuar deputeti i LDK-së dhe e ka gjetur një herë mbyllë tualetin por nganjëherë mundet me u prish dhe në shtëpitë tona na ndodhë kjo gjë.

Punimet e KEDS-it në rrugë, i ka disa kontrata që është duke punuar dhe dëmtimi i këtyre rrugëve po na shqetëson dhe neve ne e kemi thirr operatorin ekonomik dhe menaxherin e kësaj kontrate dhe kemi marrë përgjigje që të gjitha do të sanohen dhe do të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Regjistrimi civil, të dhënat të cilat i kemi deri më tani nga agjensioni i statistikave të Kosovës është 42,000.00 rezident nëse nuk gaboje, për ne është shumë dekurajuese sepse ka rënë numri i qytetarëve të gjithë e dini ka mungesë të fuqis puntore. Ka mungesa familja, kjo ka me ndikuar në zvoglimin e asambleistëve, zvoglimin e buxhetit për kok banori, kemi me pas pasoja të mëdha por besoj qeveria qëndrore ka me dhënë rekomandime të reja.

Lulet të cilat janë vyshk në bulevard operatori në një të ardhme të afërt ka me i largu ato dhe ka me i mbjellë të reja sepse kjo është në kuadër të kontratës nuk kemi me shpenzuar para për këtë gjë. Pagesa e hidroregjionit ne e kemi një marrëveshje me ta dhe tani jemi në proces të pagesave do të përfundojnë.

Nxënësit të cilët shkojnë në Therandë unë vetë kamë qenë në Prishtinë sepse drejtimin të cilin kamë dëshiruar unë nuk ka qenë në Komunën e Malishevës, për këtë arsye shkojnë në ndonjë drejtim që ne nuk e kemi në asnjërin prej shkollave këtu.

Pluhuri në rrugë është shqetësuese po përpiqemi kur të i kemi temperaturat e nxehta të shkojmë me ujtitjen e këtyre rrugëve me qëllim mos të kemi pluhur.

Ndriqimi publik jemi në fazën e vlerësimit të kësaj nevojë të qytetarëve, është në prokurorim publik dhe besoj që ky institucion do të i marrë hapat e nevojshëm për ndriqimin e hapsirave tona publike. Dëmet nga breshëri besoj që ministria e bujqësisë do të i kenë parasysh, komisionet tona do të veprojnë dhe do të i vizitojnë ata fermer të cilët ju kanë shkaktuar dëme në produktet

bujqësore.

Mos funksionalizimi i rrugëve alternative, ju e dini qfarë rrugë kanë qenë dhe qfarë janë tani, mundësit e tona i kemi shfrytëzuar e kemi bërë një rrugë dhe atë rrugë e kemi hap me shumë probleme nga qytetarët, të tjera rrugë nuk kemi pasur mundësi të i hapim. Tani jemi në bisedime me disa pronar që ta hapim një rrugë të re besoj që shërbimi i kasdastër dhe gjeodezis është në proces e sipër dhe do të i kemi të dhënat e rrugëve nëse kemi marrëveshje me ta.

Rekomandimet të cilat vijnë nga ministria për femicidin kanë ardhë shumë vonë dhe nuk kemi mundur me i përfshi në projekt bugjetin tonë. Besoj që ka pjesa e dytë të këtij viti në rast se na jepet mundësia bugjetore që të i plotësojmë këto rekomandime do të shkojmë në atë drejtim, në të kundërtën do të kërkojmë nga qeveria qendrore që të na ribursojë në bugjetin tonë të Komunës me qëllim që ti plotësojmë këto rekomandime.

Pagesa e strehimore në Gjakovë e kemi përfunduar dhe këtë pagesë dhe nuk kemi me probleme lidhur me këtë.

Informimi i prindërve për vaksinimin e fëmijëve në shkollë kjo është e domosdoshme sepse prindi dëshiron që të njoftohet dhe ta ketë kartonin për të dhënat dhe llojin e ineksionit, besoj që Drejtoria e arsimit ka me pas parasysh këtë fenomen dhe do të i njoftojë të gjithë prindërit në rastin e vaksinimit.

Ndërprerja e energjisë elektrike ju e dini që e kemi një marrëveshje me KEDS-in kjo është e përfshirë në raportin tim që do ta paraqes më vonë para jush. Marrëveshje e cila nënkupton instalimin e një kalbllor të re elektrike që përçon më shumë rrymë në bazë të të dhënave të cilat i ka dhënë inxhinierët e elektro energjetikës kanë thënë që kjo kablo na mundëson neve që gjatë sezonës së dimrit dhe sezonës së verës kur kemi ngarkesa më të mëdha të mos kemi reduktime të mëdha të rrymës elektrike.

Uji i pijes edhe këtë qështje e kam të pasqyruar në raport ju informoj me raport.

Ndërprerja e ujit në QKMF pas ardhjes së energjisë elektrike, ne do të duhej ta hapnim një pus aty por dhe shkollat dhe objektet e qëndrimit social që i kemi aty të gjitha institucionet të cilat i kemi në mbikqyrje kanë mbetur pa ujë, por besoj që në një periudhë të ardhshme do ta hapim një pus për QKMF.

Mbeturinat në aeroport dhe aty e ka nënshkruar një operator ekonomik dhe shumë do të i largojnë.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Astrazup, Arlind do ta kemi në konsiderat këtë disa i kemi në kontrata. Kjo rruga që menaxhohet nga qeveria qendrore përkatësisht nga ministria e transportit e që është në qendër të fshatit kjo Ministri e ka bërë një nënkalim për nxënës dhe kisha kërkuar prej komunitetit dhe nga drejtori i shkollës me shfrytëzuar nënkalimin. Por dhe pengesat në rrugë do të i vendosim mirëpo ne si Komunë nuk kemi të drejtë të bëjmë një gjë të tillë. Drejtorët e rinjë janë dy, Qëndresa Bytyqi dhe Valbon Hoti këta dy drejtor e kanë filluar punën në bazë të statutit që është miratuar në këtë asamble.

Njëri prej Komandantëve të UÇK-së Isni Kila është liruar nga akuza dhe është afër familjes së vetë për ne është një lajmë pozitiv si për ne ashtu dhe për qytetarët e Malishevës.

Faleminderit shumë për angazhimin e juaj.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Faleminderit Kryetar për përgjigjet.

Kalojmë te rendi i ditës, a ka dikush propozim apo diskutim për rend të ditës?

Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Unë dua të propozojë që të shtohet dhe raporti për Barazi gjinore i cili ka qenë në mbledhjen e fundit por ka pasur nevojë për plotësim ndryshim.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ajo që kërkoj është që kërkesat të cilat janë për ndihma, të cilat janë të renditura në fund të vendosen të parat, dhe pika numër 6 e cila është shqyrtimi i planit të prokurorimit për vitin 2024, konsideroj që kjo pikë në kohën në të cilën jemi tani nuk e di sa ka kuptim për diskutim. Propozojë që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Ne e mbështesim propozimin e Valonit për pikat nga numri 18 që të kalojnë të parat kërkesat për ndihmë momentale. Ndërsa sa i përket propozimit tjetër me largu nga rendi i ditës planin e prokurorimit unë kam kërkuar në KPF që të futet në rend të ditës më mirë vonë se kurr. Janë disa qështje që kam kërkuar dhe në KPF e kemi lënë me diskutu këtu, janë disa kontrata të cilat duhet me i diskutu.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Pajtohem me Valonin, në maj po e diskuton një plan prokurorimi kur kemi pasur me diskutu në mars, nuk kemi diskutu për arsye të kontratave apo planifikimeve të punimeve në teren. Kjo nuk duhet të largohet sepse duhet ta diskutojmë. Te kërkesat jam i pajtimit me qenë të parat sepse mundemi mos me arritë me i përfunduar të gjitha të paktën kërkesat të kalojnë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Shkojmë me propozimet, propozimi i parë ishte që kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/639 që të i bashkangjitet pikës së 13.

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Muharrem, një pyetje vendimi i parë është për këmbim prone, a duhet një vendim tjetër me nda prej vendimit të parë për parcelat e mundshme të cilat ka me i dhënë kuvendi?

**Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit):** Kërkesa e palës ka ardhë në KPF me këmbyer pronën për arsye se e ka fituar në procedurë gjyqësore pronën në fjalë, ky është propozim i Kryetarit nëse kërkesën e palës e miratoni ju, pastaj është propozimi i Kryetarit cilat prona munden me hy në proces të këmbimit. Këto janë dy pika të përbashkëta ka me u shpallë zonë në interes të përgjithshëm publik ajo zonë, sipërfaqja është e cekne sepse pala e ka paraqit në bazë të vendimit gjyqësor, pronat publike Kryetari i ka ofru nëse ju vendosni me marrë si zonë me interes të përgjithshëm publik, janë zonat të cilat i ofron Kryetari pronat publike për vlersim, është faza e parë fillestare që do të shkojë në ministrin e pushtetit lokal. Mbas konfirmimit të ligjshmërisë të dy pronat do të shkojnë në ministri të financave do të vlerësohen. Në bazë të vlersimit të financave ju keni me vendos me i këmbyer.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është që kërkesa 01/639 si plotësim i pikës së 13 kush është për që të hyjë në rend të ditës?

24 anëtarë jemi prezent

Për-23,

Kundër- 0,

Abstenim- 1.

Me 23 vota Për, 0- Kundër, 1- Abstenim hynë në rend të ditës në kuadër të pikës së 13.

Propozimi i Valon Mazrekut që pika 18, 19, 20 dhe 21 të renditen si pika të parë në rend të ditës.

Kush është për këtë propozim?

Me vota unanime këto pika renditen si pika të para në rend të ditës.

Kërkesa e Amrush Helshanit që të hyjë si pikë e rendit të ditës raporti i punës për Barazi gjinore, si pikë e fundit. Kush është për?

Unanimisht hynë si pikë e rendit të ditës.

Valon Mazreku e tërhek propozimin që pika e 6 të largohet nga rendi i ditës.

E hedhi në tërësi rendin e ditës me plotësim ndryshimet e bëra, kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime miratohet ky rend i ditës, me 25 anëtarë të pranishëm.

### **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/529 datë: 16.11.2023
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/17 datë: 12.01.2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/342 datë: 11.07.2023
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/56 datë: 06.02.2024
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/610 datë: 15.05.2024, për formimin e Këshillit Organizativ për krenimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës Janar-Dhjetor për vitin 2023.
7. Shqyrtimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2024.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/511 datë: 26.04.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/528 datë: 29.04.2024, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024.
10. Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2024.
11. Shfuqizimi i vendimit nr.02/120 datë: 29.02.2024.
12. Shqyrtimi i planit të Drejtoris së Bujqësis, Pylltaris dhe Zhvillimit rural për mbjelljet pranverore për vitin 2024.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UQK-së si dhe Martirë të luftës për vitin 2023.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veqanta për vitin 2024.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i i planit të punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të luftës së UQK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024.

16. Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesës nr.02/207, datë: 20.05.2024.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 01/ 639 propozimi i Kryetarit të Komunës për parcella të cilat janë në dispozicion për vlerësim në procesin e këmbimit.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/203 datë: 17.05.2024.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/179 datë: 19.04.2024.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 datë: 21.05.2024.
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1409 datë: 26.10.2023.

Vazhdojmë me pikën e parë shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/529 datë: 16.11.2023.  
Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Meqenëse këto 4 kërkesa kanë të njëjtën natyrë dhe gjithmonë jemi dakordur për qmimin. Te shuma sa me i nda 1000-1500 besoj dhe Kryetari i shikon mundësitë financiare.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi

**Drejtori për Buxhet dhe Financa- Blerim Thaçi:** Nebihi i ceki disa qështje të kategoris të subvencioneve sidomos të lehonat, qështja e bursave të cilat i ceki një asambleist në këtë vit kemi pasur një planifikim më të ulët se vitin e kaluar duke shtuar dhe faktin që prej kësaj kategorie paguhen dhe shërbimet e varrimit, po ashtu dhe transport i nxënësve hynë në këtë kategori. Jemi shumë keq vetëm nëse ne mund të i sigurojmë prej të hyrave vetanake shtesë, sepse planifikojmë që deri më datën 15.06 të realizohet planifikimi i të hyrave vetanake dhe në të hyra shtesë të planifikojmë një pjesë për këtë kategori. Unë e di që është një kategori e ndjeshme të këto kërkesa sepse kanë nevojë nuk kisha thënë që të anashkalohen por të paktën të mendohet për të ardhmen sepse do të dalim keq si institucion nëse nuk mundemi të i përfundojmë obligimet.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Unë propozoj që shuma për këto me qenë 1,500E.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është për që këtyre 4 kërkesave 02/529, 02/17, 02/342, 02/56 të ju ndahet shuma 1,500E kërkesa për trajtim të sëmundjeve?  
Unanimisht miratohen këto kërkesa.

Vazhdojmë me kërkesën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/610 datë: 15.05.2024, për formimin e Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Formula është si herën e kaluar Kryetari i Komunës, Kryesusi i Kuvendit, Drejtori i Kulturës dhe nga një anëtarë nga çdo subjekt politik, dhe një anëtarë nga shoqata e dalura nga lufta  
Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ne propozojmë Astrit Sertollin.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

**Mirë Linda Gashi (anëtare nga PDK):** Ne propozojm Alban Kastratin.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Hamit Lima!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Ne propozojmë Arlind Morina.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo):** Valon Krasniqi.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Donjetë Shijaku!

**Donjetë Shijaku (anëtare nga AAK):** Eqrem Morina.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Po i cekim të gjithë emrat Ekrem Kastrati, Argjend Thaçi, Fitim Shala, Astrit Sertolli, Alban Kastrati, Arlind Morina, Valon Krasniqi, Eqrem Morina. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Po vazhdojmë me pauzë rikthehemi vazhdojmë me pjesë të dytë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Vazhdojmë pas pauzës Urdhëro, Arlind Morina.

**Arlind Morina (anëtar nga LDK):** Kërkoj falje që po dal jashtë rendit të ditës por është një shqetësim shumë i madh sepse sapo pash një lajmë që një fëmijë i moshës 2 vjeçare ka rënë në lumin te stacioni i Autobusave dhe u dashtë të reagoj, duhet të i merrni masat e nevojshme Kryetar, që mos të ndodhin më raste të tilla pasi që mund të përfundojnë dhe me fatalitet. Kërkoj dhe reagimin tuaj si Kryetar i Komunës, po ashtu kërkoj nga Drejtoria e Inspektoriatit dhe Drejtoria e Urbanizmit që të i marrin masat ndaj Kompanive të cilat janë duke i përfunduar punët në sheshin e qytetit që të sigurojnë që jeta e qytetarëve dhe fëmijëve të mos rrezikohet. Fëmija i cili ka rënë në lum i dëshiroj shërim të shpejt dhe lusim me qenë rasti i fundit.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës Janar- Dhjetor për vitin 2023. Urdhëro, Kryetar!

**Kryetari i Komunës- Ekrem Kastrati:** Fillimisht ndaj shqetësimit me Arlindin që fëmija i cili ka pësuar aksident, mirëpo fëmija ku ka pësuar aksident gjithmonë ka qenë pa mburoja ai vend nuk është që operatorët ekonomik aty kanë shkaktuar ndonjë dëmtim. Nuk është që unë dua të arsyetohem ajo pjesë është e vërtetë që duhet të rrethkohet, fëmija është 3 vjeçar dhe gjithmonë duhet me u shoqëruar me prindin sepse gjithmonë janë të rrezikuar.

Të dashur qytetar të Komunës së Malishevës, të nderuar asambleistë dhe të gjithë ju të pranishëm në mbështetje të ligjit për vetë qeverisje lokale, statutit të Komunës por dhe planin e punës për vitin që e kemi lënë pas kam nderin që sot para jush po e prezantoj raportin e punës për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023. Mora kritika që raportimi është i vonshëm por dhe vitin që ka shkuar kemi raportuar pikërisht në muajin Maj dhe jemi konsultuar me ligjin që kemi të drejt të raportojmë deri në fund të muajit Maj. Ky raport të cilin besoj që në verzionin elektronik e kemi pasur mundësin ta pranoni secili prej jush. Ky raport paraqet mënyrën 1 vjeçare të punës tonë, të arriturat e Komunës duke mos lënë anash dhe sfidat me të cilat të gjithë së bashku jemi ballafaquar. Para se të kalojmë te pikat kryesore të këtij raporti dua të theksoj që viti 2023 ka qenë

një vit shumë sfidues fillimisht për arsye të krizës me inflacionin që pat një impakt negativ duke dëmtuar në tërësi shoqërinë tonë, pa varësisht kësaj nësi qeverisje Komunale në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë ju si trup legjislativ por dhe me partnerin e koalicionit vlersojmë që ja kemi dalura që me sukses të vazhdojmë realizimin e projekteve në të mirë të qytetarëve dhe në funksion të jetësimit të Malishevës urbane. Si Kryetar i Komunës së Malishevës jam shumë i kënaqur me punën dhe suksesin e arritur nga qeverisja jonë e përbashkët Komunale gjatë vitit që lamë pas. I jam shumë mirënjohës të gjithë Drejtorëve dhe punonjësve të administratës Komunale që në vazhdimësi kanë qenë të përkushtuar të punojnë zellshëm që qytetarëve të Komunës së Malishevës të ju ofrojmë shërbime cilësore që ata e meritojnë. Duhet theksuar që ndër objektivat e tona kryesore përveq investimeve në infrastrukturën e qytetit është dhe transparenca dhe llogaridhënia. Për këtë Komuna jonë është duke u renditur lartë në raportet e organizatave serioze që në vazhdimësi bëjnë monitorimin e qeverisjes në nivel lokal.

Ndër aktivitetet apo angazhimet tona kryesore janë: Bashkëpunimi me qytetarët, investimet kapitale, Furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë të pijes, përkrahja e familjeve në nevojë, si dhe realizimi i planit të punës sipas Drejtorive.

Bashkëpunimi me qytetarët jemi zotuar që qytetarët do të kenë një tretman të domosdoshëm gjatë qeverisjes tonë 4 vjeqare, ashtu jemi angazhuar gjatë kësaj periudhe raportuese për vitin 2023.

Investimet kapitale siq e dimë gjatë dy viteve që lamë pas Komuna e Malishevës është shpallur Komuna numër 1 në vend sa i përket realizimit të buxhetit për investime të kapitalit. Doja ti veqoja dy projektet kryesore investimi më i madh kapital në gjithë historinë e zhvillimit të Malishevës është është projekti ndërtimi i sheshit dhe parkingut nëntokësor dhe infrastruktura nën dhe mbi tokësore në qytetin e Malishevës. Ky projekt është 3 vjeqar dhe vazhdon për gjatë viteve 2024-2025. Ndërsa projekti i dytë më i madh në të cilin është punuar më shumë gjatë kësaj periudhe të raportimit është ndërtimi i rrugës kryesore bulevardit "Ibrahim Mazreku". Nga ura deri te dalja e rreth rrotullimit ky projekt ka përfshirë asfaltim të rrugës 1500m largësi, trotuari 3000m largësi, kanalizimi 2500m, ndriqimi publik 3000m, shenjzimi horizontal dhe vertikal 4500m, dhe shtegu për biçikleta 1500m. Për me u realizu mirë dhe drejtë na është dashur të reagojmë për lirin e hapsirave publike kjo ka qenë njëra prej sfidave dhe vështirësive e cila na ka shoqëruar gjatë vitit 2023, po vazhdojmë dhe në vitin 2024 dhe kështu të shkojmë drejt realizimit të objektivave tona.

Furnizimi me energji elektrike, në bashkëpunim me KEDS në vitin 2023 kemi bërë të gjitha përgaditjet për të filluar një projekt të rëndësishëm vendosjen e një kabllu përques shumë cilësor për gjatë vijës ajrore Malishevë- Rahovec. Ky projekt ka filluar dhe pritet të zgjasë si proces rreth 45 ditë, presim të eliminohen problemet me energji elektrike gjatë dimrit që vjen, megjithëse kjo është një zgjidhje e përkohshme. Jemi duke biseduar dhe me Kost jemi duke bashkëpunuar për ndërtimin e trafostacionit prej 220kV në Malishevë. Deri më tani e kemi ndarë parcelën përmes asamblesë, ju e kemi votuar vendin ku duhet të ndërtohet ky trafostacion dhe kështu që tani jemi në procedurë. Besoj që ministria përkatësisht KOST-i do ta ketë parasysh nevojën e kërkesave të qytetarëve të Komunës së Malishevës që sa më shpejt të jetë e mundur me filluar ndërtimi i këtij trafostacionit.

Furnizimi me ujë të pijes, ju e dini që vazhdimisht po përpiqemi që kjo nevojë e domosdoshme e qytetarëve të Komunës së Malishevës të jetë sa më shpejtë të jetë e mundur, në këtë drejtim

kemi gjurmuar shumë mirëpo deri më tani nuk kemi ndonjë rezultat konkret. Kur ne kemi shkuar me kërkesë konkrete në Ministrinë e planifikimit hapsinorë përkatësisht në qeverinë e Kosovës na është thënë që kjo është punë e qeverisë dhe duhet të merret qeveria qendrore më pastaj qeveria ka themeluar një grup ndërministror ku ka kyqur Komunën e Klinës, Malishevës dhe Ferizajit, kjo ekip e ka parë që ti hulumtojë mundësit e furnizimit me ujë për këto 3 Komuna. Në shtator të vitit të kaluar ky këshill ndërmjetësor është takuar dhe deri më tani nuk kemi ndonjë rezultat konkret. Angazhimet tona ende po vazhdojnë rreth realizimit të projektit të Radoniqit ta shohim a po e marrim përkrahjen e nga qeveria qendrore.

Përkrahja e familjeve në kushte të veqanta ekonomike sociale, komuna e Malishevës është një ndër Komunitat që përmes politikave të saj ka arritur të ju dal në krah në masë të madhe familjeve të cilat jetojnë në kushte të vështira ekonomike sociale. Si qeverisje dhe në bashkëpunim me donatorët gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi realizuar këto: Kemi përkrahur ndërtimin e mbi 15 shtëpive të banimit, kemi bërë hapjen e 75 bunarëve për familjet në nevojë, kemi përkrahur me pako ushqimore mbi 1000 familje, kemi përkrahur me mjete financiare nga kategoria e subvencioneve rastet me probleme shëndetsore që shumica prej tyre kanë marrë aprovimin nga ju.

Kur jemi te projektet e tjera të cilat janë realizuar nga qeverisja jonë komunale ndoshta është e rëndësishme ti cekja vetëm disa prej tyre: ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale të cilat disa i kemi në proces dhe disa pritet të ndërtohen, renovimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit të ujrave të zeza në fshatrat e Komunës së Malishevës, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Turjakë, ndërtimi i fushave sportive në fshatrat Goriq, Berishë dhe Stapanicë, ndërtimi i garazhdave në QKMF, renovimi i objektit të QKMF-së dhe rregullimi i oborrit, pollazit dhe rrethojës në QKMF. Punimet në stadiumin e qytetit Liman Gegaj ku investimet në këtë drejtim nuk na kanë shkuar dëm sepse u cek nga asambleisti që tashmë klubi ynë Malisheva është kualifikuar në garat evropiane. Ndërtimi i rrugës Sabit Berisha dhe rregullimi i palestrës sportive, trajtimi i deponive inerte, ndriqimi publik dhe renovimi i tyre në fshatrat e Komunës së Malishevës, Hapja e objektit të ri të qerdhës në Malishevë, hapja e qerdhës në Kijevë e të tjera. Janë dhe shumë projekte të tjera që janë realizuar gjatë vitit 2023 për të qenë korrekt secili projekt është më i rëndësishëm se tjetri por për të mos ju marrë më shumë kohë nuk do të theksoj pikë për pikë, gjithsesi janë të paraqitura në raportin të cilin e keni në verzionin elektronik. Për fund më lejoni që të ju theksoj që ky është një prezantim në pika tejet përmbledhëse e gjithë asaj pune të madhe që kemi bërë si qeverisje komunale gjatë këtyre viteve dhe në bashkëpunim të mirë me secilin prej jush. Mendoj që puna jonë që kemi bërë qoftë nga zyra por më shumë nga terreni ka marrë tashmë përkrahjen e duhur të qytetarëve tanë dhe që me punën tonë dy viteve të fundit jemi munduar që të veprojmë në të mirë dhe interes të qytetarëve tanë sa i përket investimeve kapitale. Gjatë vitit të kaluar Komuna e Malishevës ka marrë një grant në bazë të performancës së saj, andaj ju falenderoj juve si legjislativ, puntorët e administratës dhe Drejtorët që kanë bërë të pamundurën që ne të kualifikohemi në mesin e shumë pak Komunave për të marrur këtë grant. Faleminderit të gjithë juve që keni kontribuar gjatë vitit 2023 që të jemi pjesë e sukseseve, dhe kritikati jemi të hapur të i pranojmë aty ku vërtet ka kuptim.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Faleminderit Kryetar për prezantimin e këtij raporti të punës për vitin 2023, hapim debat rreth kësaj pike. Urdhëro, Nebih Bibaj!



**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Kryetar, unë mendova që ishe duke fol për vitin 2024, mirëpo ti kishe qenë duke folur për vitin 2023, tani jemi në muajin qershor 2024 ne po flasim për një raport që thotë Janar-Dhjetor 2023. Te raporti kur foli Kryetari për vitin 2023 gjitha ato që i cekti unë i pash disa elemente të cilat nuk kanë ndodhë nuk ka shkuar as skavator te Bubli. Në vitin 2023 nuk keni filluar fare, pjesa e parë e mjeteve janë bartë në pjesën e parë të vitit 2024 prapë nuk ka ndodhë një fillim i punimeve aty. Në periudhën e parë kanë qenë të zotuar dhe kontraktori nuk ka filluar me punuar, ju nuk i keni dhënë punë për arsye të mungesës së mjeteve. Kyqna sërish te raporti i Drejtorit.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo):** Unë dua të ndërlihem me qështjen e shtëpive të ndërtuara që kanë qenë në bashkëpunim me organizatën e Katarit. A jeni në dijeni që operatorët të cilët kanë ndërtuar dhe punuar në shtëpitë e familjeve në nevojë, punimet në disa shtëpi i kanë bërë sa për sy e faqe?

A ju keni kërkuar raport atyre dhe kush ju ka pranuar punimet pa i verifikuar shtëpitë?

A jeni në dijeni që si pasojë e punimeve të dobëta në disa shtëpi për arsye të rrymës dhe ujit familja përfituese në fshatin Bardh është ballafaquar me rrezikshmëri të lartë?

Kryetar thirrni në takim punë kryesit dhe kërkoju llogari shtesë. Në vend që në këto raste të punohet dinjitetshëm nga operatorët dhe të tregohet ana humane ata kanë punë sa për sy e faqe. Në rrymë, ujë, mobilim, dhe inventar tejet të dobët. Operatorët të cilët kanë tentuar të fitojnë më shumë se sa duhet në këto raste të ju vijë turp. Neve na takon të merremi me këto raste qoftë dhe në detaje.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesë Kastarti!

**Agnesë Kastrati (anëtare nga VV):** Unë nuk dua të ndërlihem me ndonjë qështje specifike por në përgjithësi për raportin, këtë dua ta theksoj vetëm për ti treguar kujt do që e ka shënuar raportin pavarësisht që është një raport vuliminoz mbi 100 faqe, nuk do të thotë që ne nuk jemi të vëmendshëm dhe nuk e lexojmë. Unë para e kom raportin e punës të Kryetarit Janar- Dhjetor 2022 dhe raportin e punës së Kryetarit Janar- Dhjetor 2023, po e them me kompetencë të plotë që pjesë të tëra të përshkrimit të punëve janë të njëjta vetëm të marrura copy-paste prej raportit të vitit të kaluar. Kush e ka shënuar raportin dhe ka menduar që nuk e lexojmë raportin dhe nuk bëjmë të tilla krahasime, personalisht më ka ofenduar, sepse ne nuk vim këtu me fol kotë dhe pa lexuar dokumente. Unë vetëm po i cekti dy gjëra pjesa te punët të cilat i ka bërë Komuna sa i përket furnizimit me ujë është tekst i njejtë me pikë dhe presje me raportin e vitit 2022. Pjesë të tëra te Drejtoria e Arsimit janë të njëjta. Do të doja me pas një raport i cili është i ndërtuar mbi premtimet dhe zotimet e Kryetarit të cilat i ka pas gjatë fushatës, dhe jo një raport të tillë ku të shenojmë shumë mbi 100 faqe, dhe pjesë të tëra të i marrim nga raporti i vitit të kaluar.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Ajo çka më bën përshtypje është mënyra se si e prezantoj raportin Kryetari që përveq sfidave të cilat i cekti gjatë realizimit të projekteve të cilat i ka pas dhe vazhdon me i pas. Në një mënyrë e cekti dhe bashkëpunimin tërthorazi me nivelin qendror gjë të cilën Kryetari e ka cekti në shumë raste mirëpo jo dhe zyrtarët e tjerë që në një mënyrë

qëllimshëm apo jo qëllimshëm e kanë minimizuar rolin e nivelit qendror apo impaktin e nivelit qendror me investu në Komunën e Malishevës. Ka shumë projekte të cilat janë bashkëfinancim me nivelin qendror ose janë të financuara kryesisht prej nivelit qendror të cilat nuk figurojnë në raport.

Ajo çka është sfidë dhe që e cekim dhe Kryetari qështja e ujit të pijes në Malishevë, në kampanjën zgjedhore të cilën e ka pasë Kryetari që do ta zgjidhë si qështje por deri më tani nuk ka lëvizje. Ndoshta qasja duhet me qenë më rigoroze me nivelin qendror që të paktën me filluar si projekt, dhe pse po shihet që kapacitetet tona apo burimet tona nuk e furnizojnë mjaftueshëm Malishevën si qytet. Qështja tjetër ka të bëjë me mbeturinat, kompania e cila operon në Komunën e Malishevës jam i bindur që qytetarët janë të përgjegjshëm i paguaj taksat të cilat i vendos kompania, ka ndonjë që i ik pagesës por po flas për të përgjithshmen e përfundojnë si obligim. Në anën tjetër jemi vërshuar shumë nga mbeturinat inerte gjithandej në Komunën e Malishevës ndoshta duhet me ndryshuar dhe këtu me pas një qasje shumë më rigoroze në këtë drejtim. Kryetar e di që hulumtimi i juaj ka qenë në këto dy projekte dhe 90% e buxhetit po orientohet në ndërtimin e parkingut dhe sheshit të dëshmorëve, dua të di përse deri më tani nuk ka ndonjë ndonjë investim në rrugën nga ura deri te mini tranziti, që me u krijuar një nyje shumë e nevojshme për qytetarët e Komunës, sidomos tani që pritet një fluks i madh nga mërgimtarët. Po ashtu dua të di deri ku janë procedurat sepse sa kam informacion unë niveli qendror i ka nda 500,000.00E për rrugën tranzit që fillon te fshati Carrallukë dhe që del në Pallanka në Dragobil, pjesën tjetër si Komunë a jemi të obliguar na me nda buxhet për atë pjesë që me u krijuar kjo rrugë sa më shpejtë, me qenë një arterie për të ardhmen për Komunën e Malishevës.

Si zotim tjetër e mbaj mend që keni pasur realizimin e 5 qerdheve publike në Komunën e Malishevës me mjete vetanake nuk e di që e keni realizuar një prej tyre, pra fatmirësisht në këtë rast e keni pasur dhe Ministrin e arsimit e cila ju ka ardhur në ndihmë për qerdhen në Banjë dhe tani qerdhen në Dragobil. A keni bërë kërkesë sepse kam parë një thirrje publike që ka bërë zv.Ministri dhe Ministri i arsimit që kanë kërkuar që të gjitha Komunitat që kanë kërkesa për ndërtimin e qerdheve të reja apo rifunksionalizimin e objektit të cilat kanë shkollat të vjetra me i shëndërruar në qerdhe, a ju keni drejtuar ju si Komunë me një kërkesë të tillë dhe nëse po ku është si qështje?

Qështje tjetër të ndishme të cilën e kam parë që i keni anashkaluar është qështja në QMF dhe në fshatra e di që keni pasur një investim shumë të bukur në objektin e QKMF-së në Malishevë sidomos në ambientin e jashtëm oborrin dhe garazhda dhe pjesa e emergjencës, por është lënë pas dore QMF-ja në Kijevë nuk keni investim direkt që kishte qenë mirë të paktën me pas parasysh në bugjetin e ardhshëm dhe QMF-ve të tjera në fshatra qoftë në Carralluk, Pagarush etj. Sfidë tjetër është qështja e investimeve të cilat po i bëjnë në objekte të caktuara mirëpo mirëmbajtja po është sfidë për ne si Komunë po demolohehen dhe po shkatërrohen në vazhdimësi. Shembull objekti i shkollës në Lladroc nuk i ka më shumë se 5-6 vite në shfrytëzim kur i ofrohet objektit në pamjen e jashtme është shkatërru izolimi i jashtëm, i është shkatërruar gypat që bartin ujin e qatis. Duhet me pas ndonjë plan se si me zgjidhë këtë problem. sepse po na shkojnë me qindra mijëra euro për rifunksionalizimin e këtyre objekteve. Ndoshta është mirë me nda buxhet me i vendos kamerat e sigurisë në këto objektet publike që mos me i pas këto dëme që po kushtojnë buxhet shtesë me i riparuar.

Çka më bën përshtypje tani kemi me parë te raporti kur ta prezanton Drejtori, ne nuk inkasojmë

fare buxhet nga objektet të cilat i japim në shfrytëzim, Komunat e tjera qoftë prej objekteve nga operatorët privat apo objektet të cilat vetë i ndërton Komuna, kur bëhet pranimi teknik kompania e cila e ka ndërtuar atë objekt është e detyrua që të paguaj një shumë për pranimin teknik të atij objekti. Ne nuk inkasojmë të hyra nga kjo kategori përse po ndodhë ky fenomen?

Te investimet kapitale kamë thënë është viti i fundit që duhet me pas reflektim më të madh ne si Komunë sepse po bëhen dy vite që komplet buxheti po orientohet në dy projekte të mëdha mirë që po realizohen por i keni lënë në hije fshatrat dhe disa investime që janë të nevojshme duhet me ndodhë në shtator. Urojë që të i merrni parasysh këto kritika tona, ne jemi munduar si grup parlamentar me dhënë kritika konstruktive jo për inate politike. Ne si Malishevë jemi rajon bujqësor dhe të vetëm lami që mundemi me ngrit zhvillimin ekonomik qoftë të Komunës apo banorëve tonë është përmes subvencionimit të bujqëve dhe fermerëve. Më është dukur absurde që e ka buxhetin më minimal prej krejt drejtorive dhe kultura ka buxhet më shumë se sa Drejtoria e Bujqësisë. Po e orientojmë buxhetin diku tjetër, nuk po them mos me investuar në investime kapitale sepse kjo është jetike për banorët e Komunës së Malishevës dhe për të gjithë neve që jetojmë këtu.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!**

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ky raport që pasqyron punën e Kryetarit dhe qeveris komunale për vitin që e lamë pas karakterizohet nga një angazhim dhe një punë voluminoze me të gjitha sferat ku manifestohet pushteti lokal. Ajo që është si projekt më voluminoz gjatë vitit të kaluar janë këto dy projekte të mëdha transformuese të qytetit që janë të inkorporuar brenda Malishevës urbane, projekti tashmë i përfunduar bulevardi "Ibrahim Mazreku" dhe projekti i sheshit me parkingun nëntokësor. Ky projekt që është realizuar gjatë vitit të kaluar dhe që e merr pjesën më të madhe të punës të Kryetarit dhe qeveris së ti vitin që lamë pas thot që ky projekt ka pasur shumë të mira dimensionale dhe më e mira ka qenë lirimi i hapsirave publike, diçka që nuk ka ndodhur në asnjë Komunë deri më tani në mënyrë masive siç ka ndodhur në Komunën e Malishevës. Ky projekt përveç që ka rregulluar aspektin e infrastrukturës nëntokësore dhe i ka zgjidhë disa probleme të mëdha në lidhje me vërshimet që është përballur Komuna jonë, kjo i ka ra mirë dhe bizneseve të cilët me dëshirë apo pa dëshirë kanë qenë ozurpues të pronës publike por dhe qytetarëve të komunës sepse tokën të cilën ju ka ozurpu dikush ja kemi rikthyer prap qytetarëve në shërbim të tyre. Projekti tjetër që tani më është duke u realizu dhe që është parkingu nëntokësor së bashku me sheshin e dëshmorëve është prej projekteve të vetme që ka me na gjeneru të ardhura në të ardhmen.

Kemi rreth 250 parkinge të cilët në vitin e ardhshëm do të fillojë me na sjellë të ardhura për një kohë jo shumë të gjatë do ta kthejë atë investim që ne e kemi bërë në atë projekt. Nuk do të thotë që angazhimi i Komunës është orientu vetëm këtu ne e pamë dhe në sfera të tjera si Arsim, Kultur, Shëndetësi, Bujqësi etj, nuk i ka lënë anash dhe sektorët e tjerë. Dy herë është listu Komuna jonë gjatë vitit 2023 si e para sa i përket shpenzimeve të investimeve të kapitalit. Ju e dini që kriteri që e matë performancën e mirë të një qeverie është investimi i kapitalit, aftësia e qeveris komunale për me i shfrytëzuar mjetet të cilat janë të destinuara për investime kapitale. Komuna jonë me Kryetarin Kastrati nuk ka para sa ka mundësi me punuar dhe sa ka ide për me zhvillu Komunën tonë. Falë angazhimit dhe bashkëpunimit me organizata të ndryshme siç është rasti i organizatës humanitare Katar në bashkëpunim me ta ne kemi marrë pothuajse 1 milion euro

investime prej kësaj organizate humanitare që shfrytëzojë rastin me i falenderu. Unë ju inkurajoj që të vazhdoni me punuar me këtë organizatë dhe me u mundu me kriju dhe bashkëpunime me organizata të tjera të cilat kanë me na sjellë donacione apo ndihma për me rrit cilësin e jetës së qytetarëve të Komunës së Malishevës. Të gjithë e dimë që mjetet të cilat i kemi nuk na mjaftojnë me i përfundu të gjitha obligimet dhe punët të cilat i kemi, duhet me u përpjek që përmes bashkëpunimeve të ndryshme dhe pse jo me bashkëpunim me qeverin qendrore i inkurajoj kolegët e mi prej LVV-së e cila udhëheq qeverin qendrore që të angazhohen që të sjellin ndonjë investim i cili është i domosdoshëm për Komunën e Malishevës. Në rastin konkret që është qështja e ujit të pijes, ne e dimë që nuk mundemi me zgjidhë me burime të brendshme që i kemi. Qështja e ujit zgjidhet vetëm nëse ne kemi qasje në njërën prej liqejeve të mëdha që i ka Kosova dhe më së afërti i kemi liqenin e Radoniqit. Ne kurrë nuk mundemi me sjellë ujin nga liqeni i Radoniqit me të hyra vetanake. Njëra prej sfidave të cilën e cekën është qështja e mbeturinave, kjo nuk është vetëm sfidë e Komunës tonë por është sfidë e të gjitha Komunave të Kosovës. Menagjimi i mbeturinave nuk është vetëm qështje e institucionit kurr nuk do të mundet asnjë Komunë me zgjidhë problemin e mbeturinave, kjo është qështje e shoqërisë. Unë konsideroj që mbasi ku mundet me bërë një llojë kampanje për vetëdijësimin e qytetarëve në lidhje me menagjimin e mbeturinave. Nëse ne si qytetarë të Komunës së Malishevës nuk i trajtojmë mbeturinat ashtu si duhet nuk ka institucion që mundet me bërë këtë punë. Kur jemi në një nivel të tillë të emancipimit ne mendojmë atëherë me rregulluar më lehtësisht qështjen e mbeturinave. Faleminderit dhe një herë Kryetar për raportin dhe të përgëzoj për punën e mirë që e ke bërë dhe që vazhdon me bërë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush Helshani!**

**Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Shefi e paraqiti në mënyrën më të mirë të mundshme të tij punën e Kryetarit, me knaqësi e marrë fjalën për të përgëzuar punën e shkëlqyer të Kryetarit të Komunës z.Ekrem Kastrati dhe të gjitha Drejtorive të ti për angazhimin e tyre gjatë vitit të kaluar. Edhe pse këto arritje janë të pasqyruara në raport theksoj dhe një herë përparimet të jashtëzakonshme të cilat i kemi parë në këtë vitë në shumë aspekte të jetës tonë Komunale. Kryetari Kastrati me përkushtim dhe vizion të qartë ka drejtuar ekipin e ti drejt arritjeve që kanë përmisuar cilësin e jetës për të gjithë ne duke treguar përkushtim dhe vendosmëri në përmbushjen e detyrave të tyre. Arritjet dhe projektet e vitit të kaluar janë dëshmi e përkushtimit dhe vizionit të Kryetarit të Komunës z.Kastrati dhe ekipit të ti duke i vlerësuar këto përpjekje ne duhet të jemi bashkuar dhe të mbështesim njëri tjetrin për të ndërtuar një të ardhme edhe më të ndritur për qytetarët dhe Malishevën. Faleminderit për punën tuaj të vazhdueshme i nderuar Kryetar që besimin qytetar po e kthen në punë dhe angazhim, ju dëshiroj suksese.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!**

**Driton Kastrati (anëtar nga LDK):** Në lidhje me raportin e Kryetarit dua të ndërlidhem me një qështje rreth projekteve të cilat janë të evidencuara në raport, renovimi i kolektorit kryesor të ujrave të zeza faza e parë Bubël-Lumishtë. Ose kanë bërë ndonjë gabim ose unë nuk jamë duke e kuptuar sepse renovimi nuk ka ndodhë. Si ka mundur me u përfunduar si projekt kur ne i kemi destinuar mjetet për projektin e qendrës së qytetit, si dhe është votuar ai ridestinim me qëllim që

ai projekt të vijë në vitin 2024. Mbesim me shpresë që Kryetari ta rregullon në vitin 2024 sepse është një problem shumë serioz për banorët e këtyre fshatrave sidomos për bujqit e asaj ane. Po ashtu është e evidencuar në raport te projektet e përfunduara po e lexoj tekstualisht: Dalja në teren dhe përgaditja e paramasave për ndërtimin, asfaltimin e rrugëve lokale në fshatra. Në qoftëse ekzekutivi del dhe bënë masën kjo është vetëm një procedurë por nuk është projekt dhe nuk është përfunduar. Shumë projekte në fshatra të cilat kanë qenë të përfshira në buxhetin Komunal nuk janë realizuar, nuk e di shpenzimi i buxhetit a bëhet përmes pagesave avans që ju bëhet operatorëve ekonomik apo duhet të paguhen me para të buxhetit pasi të përfundoj projekti. Në lidhje me asfaltimin në fshatra më shqetëson dhe një fakt sepse përgjegjësia e jona si legjislativ dhe ekzekutiv nuk është vetëm ndaj qytetarëve të qytezës së Malishevës por është përgjegjësi që na takon në raport me të gjithë qytetarët e fshatrave dhe qytezës të Komunës së Malishevës. Kemi përgjegjësi ndaj të gjithëve kur është fjala të ekzekutimi i projekteve, kryerja e punimeve në teren ne nuk mund të bëjmë projekte në mënyr selektive sepse parat janë shpenzu sipas raporteve të cilat janë bërë publike ndërsa punimet nuk janë përfunduar në atë masë. Kemi mos përputhje dhe te plani dinamik i prokurorimit të cilin e kanë publikuar është një mospërputhje me dinamikën e punimeve.

Ne të gjithë e dimë që bugjeti kur të aprovohet bëhet ligj kemi mundësi me bërë ndryshime deri sa të votohet bugjet jo pasi të votohet. Dua ta parashtroj një kërkes që e ceki dhe kolegi Veton Zogaj në lidhje me qerdhet që në kuadër të projektit për shtrirje sa më shumë qerdhe dua të jap propozimin që në fshatin Turjak objekti ekzistues i shkollës pasi është duke u ndërtuar shkolla e re me funksionalizimin e shkollës së re, shkolla ekzistuese të shëndrrohet në qerdhe. Po ashtu një pjesë e këti objekti të shfrytëzohet dhe për ndonjë sallë kulture apo për nevoja të tjera të Komunitetit të fshatrave Turjakë, Libizhdë dhe më gjerë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Hamit Lima!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Kryetar, qysh nga fillimi i mandatit e kemi pasur në buxhet rrugën Banjë -Lladroc qka është duke ndodhur me të përse nuk fillon puna apo është ndërpre, një pjesë të mjeteve e di që e kemi bërë ridestinim për pjesën tjetër nuk e di qka ka ndodhë. E ceke që janë hap 75 puse për persona në nevojë, përse nuk ka transparencë. Kryetar, përse nuk ka emra të personave që kanë përfituar?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Sa e kamë lexuar rendin e ditës aty po shënon raporti i punës së Kryetarit dhe koncepti i punës është më i gjërë dhe më gjithë përfshirës sesa investimet kapitale. Punë e Kryetarit është dhe nëse takohet me një qytetarë dhe nëse takohet me një delegacion qfarë do qoftë. Mundohen disa kolegë që janë dhe partner të kualicionit në qoftëse kemi bërë mirë kemi bërë bashkë në qoftëse kemi bërë keq po ashtu kemi bërë bashkë, nuk duhet me kriju paralelizëm këtu sepse këta nuk janë paralel me neve por jemi së bashku. Të gjitha këto punë që i ka pasqyruar Kryetari gjatë vitit 2023 dhe ato të cilat nuk janë të përfshira në raport konsideroj që kanë qenë në emër të qeverisë komunale, në kuadër të qeveris komunale është edhe LDK. Punë e qeverisë jo vetëm e Kryetarit është me i bërë dhe matjet është punë që është bërë gjatë një viti. Projektet investive në buxhet afër 90% janë projekte më shumë se dy vjeqar, shpenzimi i buxhetit për një vit fiskal ka me mbaru dhe projekti mos me u

përfunduar sepse është e buxhetuar dhe për vitin tjetër. Kur dalim me fol duhet me qenë transparent siç po kërkon kolegu, sa e di unë kolegë është ligji për mbrojtjen e të dhënave ku nuk lejohet publikimi i emrave të përfituesve. Ato publikohen vetëm përmes kodeve apo protokolit si i kanë adresuar kërkesat. Nëse është e vërtet siç po pretendoni që filani i ka 5 rroga dhe ju është hapur bunari nëse nuk ke mundur me paraqit te Kryetari ke mundur me paraqit te Kryesusi apo te Drejtori që është i LDK-së dhe ai me diskutuar në bord.

Kryetar të falënderojmë për të gjithë punët të cilat i ke bërë, i ke dhënë premtimet dhe i ki obligim me i përfunduar të gjitha këto punë dhe konsideroj që i ke përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme. Unë e di që nevojat janë më të mëdha se mundësit por duke i rendit në prioritete besoj që janë rregulluar qështjet të cilat janë me prioritet kohor.

**Driton Kastrati (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Një replik Valonit dhe ne i gëzohemi sukseseve të Kryetarit dhe të ekzekutivit po ashtu dhe sukseseve të asambles, kam qenë pjesë e këtyre sukseseve dhe ndihem i lumtur mirëpo ne kemi përgjegjësi të bëjmë pyetje dhe të interesohemi se ku janë shpenzuar parat publike. Në qoftëse ne kemi ndonjë pyetje apo vërejtje nuk është mirë dhe nuk është hera e parë që ju tentoni me na kritikua që ne dalim dhe flasim. Fakti që ne jemi në një koalicion nuk do të thot që ne ta mbyllim gojën dhe të mos flasim. Votat që ne i kemi marrë nga qytetarët janë përgjegjësi për neve dhe ne duhet të punojmë për interesin e tyre pa dallim. Në qoftëse unë e ngris zërin për tema të caktuara nga raporti i Kryetarit nuk do të ishte mirë të më thoni pyete atë ose atë sepse ky është raporti i Kryetarit. Pa dyshim që të gjitha sukseset janë të përbashkëta mirëpo dështimet janë të atyre që ju takojnë përgjegjësit sipas ligjeve dhe rregullave të cilat i ka kuvendi dhe ekzekutivi.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!**

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** I nderuar Kryetar ne kemi thënë prej ditës së par jemi duke i parë konfrontimet të cilat janë duke ndodhur mes koalicioneve. Kemi thënë prej ditës së parë që ky koalicioni e ka formën e interesit se sa interesit të përgjithshëm qytetarë, po vërehet në këtë drejtim sepse pjesë e këtyre votimeve kanë qenë dhe Hamiti me Dritonin kanë qenë pjesë e largimit të rrugës të mjeteve kur janë bartë për rrugën që lidhet Banjë- Lladroc ku ju kam thënë që nuk është mirë me bërë tërheqjen e parasë sepse e ke projektuar.

Kryetar, qeverisja juaj duhet me shkuar në këtë drejtim përveq që ju keni zgjedhë investimin në qendër sigurisht që është investim i juaji dhe me këtë e keni fituar dhe pushtetin për Malishevën urbane. Por pjesa tjetër që është më e rëndësishme është qështja e ujësjellsit dhe te kanalizimit. Duhet të pajtohemi të gjithë këtu që kanalizimi në ujrave fekale kryesor kanë qenë para të planifikuar, kanë qenë para të alokume në një farë forme dhe kanë prit me ja filluar punëve. Ju e dini mirë përse ai nuk ja ka filluar kolektori kryesor me u ndërtuar ky është një realitet. Një shqetësim tjetër që është duke u bartur prej vitit në vit mendoj që është gabim dhe kur bëhet projekt buxheti bartja e projekteve. Nuk ndërtohen në këtë vit dhe barten, rrugën ku jetoj unë është 300metra i ka 4 herë ka hyrë në projekt buxhet kurrë nuk është realizuar. Tani duhesh me menduar ku janë parat që janë projektuar për e-kiosk, rrugë, kanalizim etj, këto pyetje i bëjnë kuvendart dhe me të drejtë. Përgjigjet e juaja është me tregu se ku gjinden këto projekte, por asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje për këto. Deri në vitin 2025 fshatrat i ki jashtë investimeve për arsye se të gjitha mjetet ti merr qendra dhe nuk i dihet a ki me ja dalë me rregulluar qendrën.

Mendoj që është vështirë me ja dalë me këtë bugjet të Komunës sepse një pjesë të hyrave po ti merr gjykata, ku janë pjesët e tjera është mirë me tregu. Më mirë projektoje në shtator se sa para të duhen me përfunduar qendrën nuk kemi nevojë me mashtruar askend në asnjë fshat. Disa qështje janë me të vërtetë brengosëse dhe shqetësuese që duhet me pas adres dhe në të njëjtën kohë përgjigje prej anës tuaj. Të paktën te kolektori presim përgjigje serioze përse po përsëritet kolektori shumë herë përse nuk ka filluar punën me kohë?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ajo që po pretendojnë disa kolegë është normale që të gjitha punët nuk mund të përfundojnë menjëherë, askush më shumë se ne nuk dëshiron me i përfunduar punët mirëpo në pamundësi e ceki dhe Nebihi buxhet i varfër, në raport me kërkesat me të vërtetë është bugjet i varfër. Ky bugjet është i ndarë sipas formulës që i takon për kok banori dhe ne nuk mundemi me shtuar vetëm në qoftëse kemi mbështetje nga Qeveria që në disa projekte na ka mbështet. Kolektori kryesor e ceki dhe Nebihi dhe kolegët e kanë votu me i bartë mjetet në projektin i cili është duke u zbatu në qytet. Besoj që dhe në fshatra ka nevojë me investu qoftë rrugë të reja, qoftë me i riparuar ato të cilat janë mirëpo të gjithë jemi pajtuar që fillimisht dëshirojmë ta rregullojmë qendrën, dhe me rregullu qendrën ka sakrificë nuk është vetëm po e rregullojmë. Përderisa ne i gëzohemi dhe ndihemi krenar për suksesin normal që na takojnë dhe përgjegjësit me i marrë sepse ato suksese nuk kanë ardhur vetëvetiu kemi punuar të gjithë së bashku, dikush në asamble dikush në qeveri. Përgjegjësi në qoftë se nuk është përfunduar një punë prap e kemi ne nuk e ka vetëm Kryetari sepse ja kemi marrë paratë një projekti dhe i kemi bartë në projekt tjetër.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro Kryetar, Ekrem Kastrati!

**Kryetar i Komunës- Ekrem Kastrati:** Faleminderit shumë për kritikën dhe sygjerimet të cilat i dhat për mua është e mirëseardhur sepse kritika është i vetmi kriter njerëzor që e përmison njeriun ku përmes kritikës ne e avancojmë vetën së pari. U diskutua kolektori kryesor Lubizhdë-Bubël ne e kemi themelur një kontratë ajo kontratë ka afatë dhe dy vite, në pajtim me operatorin ekonomik e kemi shtyrë për këtë vitë implementimin, e kemi bërë këtë sepse kam caktuar disa fonde të bashkimit evropian dhe ata më kanë premtuar që do ta marrin krejt kontratën dhe me implementu kontratën duke ndërtuar dhe një fabrikë për ujërë të zeza sepse i gjithë ai kolektor derdhet në shtratin e lumit Mirusha jo largë ujvarës së Mirushës, frika për me ndotë ujvarën ka qenë shumë e madhe. Prandaj shkresat e mia që i kamë dërguar në selin e bashkimit evropian kanë qenë dhe ambasadori ku kemi diskutu ka qenë pikërisht ndotja e ujvërs lumi mirusha, që ne po tentojmë përmes një kolektori me marrë donacion nga bashkimi evropian për ndërtimin e kolektorit dhe fabrikës për ujërë të zeza, me qëllim që ujvara të ruhet si asset turistik. Kjo ka qenë vonesa që është shkaktuar deri më sot, kur e kemi parë që nuk po mundemi me implementu atë mjetet i kemi bartur në projekte të tjera. Kurse këtë vit ja kemi filluar implementimin sepse ndihmat e bashkimit evropian ju e dini që kanë dështu sepse shteti jonë është me sanksione. Shtëpitë e ndërtuara sa për sy e faqe që e ceki Valoni, kjo ka qenë donator i Katarit secila shtëpi ka kushtuar 24,000.00E deri në 26,000.00E pjesëmarrja e Komunës ka qenë deri në 5000E në secilën shtëpi. Marrëveshjen kur e kemi bërë me Katarin nuk ka qenë që ne me zgjedhë operatorin ekonomik, sepse me 5000E askush nuk ta jep atë të drejtë as me zgjedhë as me

mbikqyr. Të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit rreth ndërtimit të shtëpive ka qenë e drejtë e Katar Qarity, ata i kanë përzgjedh se kujt me ja hap pusin dhe kujt me ja ndërtu shtëpin. Ka qenë shpallja publike Komisioni ka qenë i tyre, vetëm një anëtar ka qenë i joni dy kanë qenë prej tyre. Te projektet e Katarit si për subvencionimin e bujqëve, si për hapjen e pusëve, ndërtimin e shtëpive dhe për [ako ushqimore e kemi marrë listën në Drejtorin për mirëqenie sociale dhe ju kemi shpërnda përmes asaj liste, të gjitha aktivitetet e tjera të cilat kanë qenë përmes katarit kanë shkuar përmes Komisioneve të tyre vlersuese. Më kanë ardhë dhe në rrjetin tim social kritika me fotografi ja kamë dërguar Katarit dhe kjo nuk është në kompetencën time.

Disa projekte i kemi dy vjeqare dhe kanë figuruar në 2023 do të figurojnë dhe këtë vit.

Projekti i rrugës për gjatë lumit kjo është njëra prej rrugëve alternative që u theksu më herët që kemi mundur me shfrytëzu si rrugë alternative ne e kemi hapur, prej viva freshit deri te liqeni i Mirushës e kemi një master plan që e kemi në përpunim e sipër, dhe besoj që ky master plan do të ju pëlqej jo vetëm juve por secilit qytetarë të Komunës së Malishevës. Në atë pjesë e kemi parapa nga viva fresh deri te ura e tranzitit kjo me u trajtu si zonë rekreative e qytetit, që nënkupton vetimi i shtratit Mirusha deri te liqeni dhe pjesë shetitorja, dhe pjesa rekreative që qytetarët me pas siq është Gërmia për Prishtinën. Dhe parku i Mirushës është pjesë ndërlidhëse e këti plani dhe besoj që ngadalë secila pjesë më nxën vendin e vetë.

Rruga e tranzitit dikush e cekë që qeveria i ka ndarë 500,000.00E nuk ka ndarë asnjë para qeveria për këtë projekt. Duhet të bëhet shpronësimi i parcelave nuk ka ndodhë kjo dhe ka mbetë projekti pezull, mbetet me forca tona me rregullu. Te qerdhet ne kemi marrëveshje me Ministrin e arsimit kemi shkuar në qerdhen e Banjës e cila është gati në fazën finale të meremetimit apo riparimit sepse është shkolla e vjetër. Kemi marrëveshje dhe për ndërtimin e qerdhes në Bellanic i kemi dërgu skicat gjeodezike, dhe në Dragobil këto të tri Qerdhe janë në programin qeveritar. Kërkesa e Dritonit që shkolla vjetër në Turjakë të shëndrrohet në qerdhe, me të vërtet ai lokacion e meriton një qerdhe të fëmijëve pse jo.

Sa i përket QMF-ve te QMF-ja në Kijevë jemi në fazën finale me Katarin të dakordimit që ta ndërtojmë një qendër të mjekësis familjare në Kijevë të re, ta rrënojmë atë që është dhe të ndërtojmë një tjetër. Më kanë thënë që janë gati, donacionet i kanë siguru dhe po presim për këtë arsye nuk kemi shkuar në investim sepse qe një vit jemi në negociata me ta.

Subvencionimi i bujqësis ne të gjithë e dimë që Komuna e Malishevës një pjesë të territorit është bujqësore, po bëjmë përpjekje maksimale që ne të investojmë dhe të ecim përpara. Faleminderit për vërejtjet të cilat i bëtë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** E mbyllim debatin për këtë pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me raportin e punës së Kryetarit për vitin 2023.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është Shqyrtimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar- Mars të vitit 2024. Për prezantim të këti raporti kemi Drejtorin për bugjet dhe financa Blerim Thaqi.

**Drejtori për Bugjet dhe Financave- Blerim Thaçi:** Para jush keni raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars të vitit 2024 të gjitha shenimet i keni në raportin e shenuar. Në pika të shkurtëra do të paraqes si total bugjetin 2024 është 19745114.08E që për këtë periudhë alokimi i mjeteve kap shumë prej 11169501.23E qka do të thotë se shkalla e realizimit të bugjetit për këtë periudhë ka arrit në 56.57%. Sipas këtyre shenimeve të cilat i kemi nxjerrë



nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për periudhën Janar- Mars 2024 është në vlerë prej 6603770.2E që si përqindje totale e kap 59.12%. Te të hyrat ju e dini që realizimi i të hyrave për vitin 2024 është 916,849.00E, para jush janë të prezantuara të hyrat tremujore në shifrën prej 359,233.42 që do të thot nuk janë të futura të hyrat e tre mujorshit të parë të krijuara nga gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykata, sipas shenimeve që i kemi në drejtorinë tonë kemi mbërrir realizimin e të hyrave në shumën prej 756,000.00E që si përqindje është 82% e planifikimit të grumbullimit të hyrave vetanake në Komunë. Na kanë mbetur dhe 18% për të realizuara 100% realizimin e planifikimit të hyrave dhe ajo mundë të them me siguri të plot që sot është realizu kjo sepse kemi realizimin e të hyrave të 3mujorshit të dytë nga gjobat në trafik dhe nga gjykata. Kështu që shumë gjëra që u cekën në raportin e Kryetarit pjesa e realizimit të projekteve për veq kësaj që kemi kërkuar bartjen e mjeteve nga viti 2023 do të jetë dhe kërkesa e dytë në Qershorë për rritjen e limitit kufirit të të hyrave për këtë vitë fiskal që të realizojmë shpenzimin dhe mjeteve të tjera që hynë shtesë. Atë planifikim do ta paraqesim në Qershor, por sipas të gjitha parashikimeve që janë deri më tani duke shkuar me realizimin e të hyrave në këtë vitë planifikojmë që të kalojmë 2,000,000E në realizimin e të hyrave nga të hyrat vetanake.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Në vazhdimësi kam pasur fjalë të mira sa i përket të hyrave vetanake në raport me vitet paraprake sa i përket kësaj kategorie kemi përmisim si Komunë ka ndiku dhe vetëdijësimi i qytetarëve që po i përfundojnë me kohë obligimet e tyre. Ajo qka më ka rënë në sy është paraqitja e të hyrave në mënyr analitike, vërehet dukshëm një rënie në disa kategori. Shembull të qertifikatat tjera në raport me periudhën e njëjtë kohore kanë qenë afër 14,095E tani i kemi më pak se 2,000E pra ka rënie kjo kategori.

Po ashtu të taksat komunale për ushtrim të veprimtarive 3,000 kanë qenë tani janë 1,500E nuk e di për qfarë veprimtari bëhet fjalë dhe përse ky përgjysmim.

Gjobat nga inspektoriat kam pasur një bised me Drejtorin e inspektoriatit dhe më ka thënë që na inspektorët Komunal kemi dhënë gjopa të cilat nuk kanë receiptu kurrë si e hyrë. Ka qenë numër i përfillshëm me shumat që mi ka dhënë sa është gjobit një biznes i caktuar ose një qytetarë i cili ka një kompani. Tani i kemi 105E, i kemi pasur 375E herën e kaluar ëshë prap një rënie.

Shfrytëzimi i pronës publike është një rënie shumë e madhe është 7311E periudha në kohore, nuk e di tani për veq pishinës së Banjës dhe sa prona të tjera i kemi në shfrytëzim dhe përse nuk kemi gjenerim në këtë kategori?

Tatimi në pronë ka shumë rënie 5,000E në këtë periudhë kohore.

Sa kam informacion në këtë vitë ka hyrë si pagesë dhe tatimi për pronën bujqësore.

Liqencën për afarizëm këtë vite e kemi 0. Nuk po e kuptoj së pari për qfarë liqenca dhe përse e kemi 0?

Lejet mjedisore i kemi pasur 9585E në vitin 2023, në periudhën e parë kohore e kemi 3196E.

Participimi në shëndetësi edhe këtu ka rënie.

Ngritje ka në qerdhe po shihet ka ndiku rritja e kapacitetit në Malishevë dhe Kijevë.

Kaq sa i përket pjesës në mënyr analitike. Të shpenzimet në periudhën e njëjtë kohore shohim një

ngritje sa i përket tatimit nga TP nuk po kuptojë për qka bëhet fjalë. Në raport tani i kemi 155,000E në 2023 i kemi pasur 125,000E.

Janë me shkurtesa kontribut pension pundhënësit dhe këtu kemi ngritje.

Shpenzimet për udhëtim jashtëvëndit i kemi 3880E në vitin e kaluar i kemi pasur 251E është rritje shumë e madhe. Shpenzimet e telefonis mobilie është 10,000E në vitin 2023 e kemi 0.

Pastaj e kemi 14520E shërbime të veqanta konsulente dhe kontraktor është shumë e lartë për konsulent. Shërbime teknike për qfarë shërbime teknike po bëhet fjalë i kemi 2147 që i kemi pasur në të kaluarën tani i kemi 14543E.

Shpenzimi për antarësim edhe kjo është ngritë në të kaluarën ka qenë 8000E tani është 15571E i kemi tani.

Mobilie 36878E në të kaluarën ka qenë 0. Paisje specialistike mjekësore 2799, 0 në të kaluarën. Mirëmbajtja e ndërtesave 66,268E, ndërsa ka qenë 6202E në periudhën e njëjt kohore është shumë ndryshim i madh. Mirëmbajtja e rrugëve 18,000E ndërsa 0 e kemi pasur. Shpenzimi për informim publik e kemi 720E, 416 e kemi pasur.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Gjobat nga gjykata sigurisht i keni përfshi këto të bujqësis apo Drejtori Syl. Jo nuk qenkan këto është shqetësuese që është 0. Raportet janë të inkorporuara me vonesë nga ministria, pra ne nuk kemi të drejt me ngrit si qështje të cilat dojnë shpjegim të mëtutjeshëm, nëse ti na bindë që janë raporte të ministrisë në rregull por 0 me pasë nga gjykata është shqetësues.

Kemi ngritje sipas kategorive të shpenzimeve për mallra te tabela 7.4 e cekit dhe Vetoni më bën përshtypje ngritja te Karburantet ka përdorim të veturave zyrtare nga Drejtorët ndoshta dhe pa autorizim të Kryetarit. Ndoshta po bëjnë dhe fushatë në fshatra.

Udhëtimet zyrtare jashtë vendit ka një ngritje sigurisht që është kjo pjesa që ke qenë në Amerik dhe në Evropë diku. Ka një ngritje të jashtëzakonshme që në 2023 nuk ka pasur është shpenzimet e telefonis mobilie janë 100,000E. A janë para të bartura të vitit 2023 apo qfarë është? Kemi shërbimet kontraktuese, mobilie 36878E ndërsa në vitin 2023 të njëjtën periudhë nuk i ke asnjë cent të shpenzuar. Në këtë shumë a përfshihen dhe mobiliet e kuvendit apo jo? Furnizimet me veshëmbathje a është e zjarrëfikësve kjo pjesë?

**Drejtori për Bugjet dhe Financa- Blerim Thaçi:** Është e zjarrëfikësve, inspektoriatëve, zyrtarë të tatimit në pronë, shëndetësia komplet.

**Nebih Bibaj (anëtar nga PDK):** Në të njëjtën periudhë në vitin 2023 ka pasur mjete të shpenzuara për këtë pjesë. Avanc për udhëtime zyrtare ka një ngritje shumë të madhe prej 8000E.

Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve dhe këtu është një rritje a ka ndonjë blerje të veturave apo janë vetura të njëjta? Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve sigurisht q'ëka një rritje.

Mirëmbajtja e ndërtesave shumë herë jemi duke e ngritur këtë prej 6202E tani e kemi 66288E janë rrit shpenzimet. Mirëmbajtja rrugore nuk e di përse e keni shenu këtë 18.000E është dashur ta shenoni 0 sepse nuk janë mirëmbajtur nëse flasim për gropa. Besoj që duhet me na spjegu te këto emërtimet sepse nuk po mundemi me i akceptu. Në këtë raport ka projekte të bartura edhe këtë vitë uroj që të realizohen. Uroj që të realizohet dhe ekioski në Kijevë sepse është i

domosdoshëm për pjesën Gullubovc e andej për arsye të dokumentave të gjendjes civile. Është mirë të mos përsëritet në vitin e ardhshëm por të realizohet këtë vitë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** A ka dikush tjetër për diskutim?

Nëse jo ja kaloj fjalën Drejtorit me u përgjigj. Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

**Drejtori për Buxhet dhe Financa- Blerim Thaçi:** Së pari dua të përgjigjem te tabela që janë shpenzimet për paga janë nxjerrë nga sistemi me paga, pensione të gjitha. Te qështja e realizimit të hyrave vetanake po ndërlihdna me këtë që e ceku Nebihi që janë 0. Pasqyrat e të hyrave vetanake që krijohen në nivel vendi ato kanë ndodhë që deri më 15.04 qdo tre mujor i sjellin të dhënat se sa janë kriju nga niveli qëndror. Në atë kohë ne e kemi bërë raportin, raporti i paraqitur këtu nuk i përfshin 77,000.00E. Në raport është e paraqitur 8.29% rritje mbi bazën e periudhës 3 mujorshe, në të vërtetë është më shumë.

Te qërtifikatat e lindjes e kamë spjegu dhe te Komiteti që është shuma e vogël 146E është për qertifikatat për banorë jo rezident, për qytetarët që janë jashtë vendit është kod i specifikum. Taksa për ushtrim të veprimtaris është në ulje por nuk caktohet periudha e kryerjes së obligimeve ajo mund të bëhet në Prill por mos me qenë në tre mujorshin e parë. Gjobat nga inspektoriat Drejtori ka thënë me të drejtë që kanë shqiptu gjoba dhe janë realizu si të hyra por pjesa më e madhe e gjobave janë inkasu me përmbarues dhe nuk paraqiten si gjobë te inspektoriat por si të hyra vetanake nga gjykata. Shfrytëzimi i pronës publike është një qështje që sjellë të hyra nga shfrytëzimi i pronës në periudhën tre mujore nuk e ka kry pagesën sigurisht mund të jetë përfunduar pagesa në tre mujorshin e dytë. Leje mjedisore prap diktohen nga kërkesat e operatorëve që kanë qështje ndërtimore, megjithëse për periudhën Prill- Maj ka pasur rritje. Participimi në shëndetësi ka të bëjë me vizita mjekësore dhe ajo që e ceke participimi në qerdhe është fakt sepse është numri më i madhë i fëmijëve në 3 qerdhe. Shpenzimet jashtë vendit edhe kjo diktohet nga realizimi i vizitave jashtë vendit, kane ndodh dy vizita jashtë vendit në këtë periudhë, në vitin e kaluar nuk ka pasur vizita por këtë vitë dhe në kuadër të kësaj hynë dhe avancet ka dhe trajnime të cilat bëhen në shqipëri apo në ndonjë vend tjetër. Shpenzimet e telefonis mobile është 10,000E për periudhën tre mujore nuk kemi mundur me përfundu obligimin për 7-8 muaj operatorit, dhe kemi qenë të obliguar me i pagu 10,000E ndërsa kemi dhe një pjesë të mbetur për muajin Prill. Shërbimet konsulente dhe shërbimet kontraktuale është kjo shumë mundem me thënë është pjesë e obligimeve një pjesë të vitit të kaluar dhe pjesa tjetër në tremujorshin e parë. Për vitin 2023 ndodhë që nuk kemi pasur obligim dhe nuk ka pasur shpenzim. Shërbime teknike e njëjta gjë në bazë të obligimeve të vitit paraprak në fund vit. Mobilie në vlerë më pak se 1000E kemi shumë procedura që zhvillohen në kontratën më pak se 1000E. Në rastin konkret kemi pasur te mobilimi i institucionit së qendrës sociale, që kemi bërë bartjen prej objektit të vjetër te objekti i stacionit të autobusëve dhe është dashur të furnizohen me disa paisje për të cilat është bërë dhe ky shpenzim. Te mirëmbajtja e ndërtesave kemi kontrata ku njëra prej tyre është mirëmbajtja e objekteve që është e përjetshme, mirëpo dhe mirëmbajtje të tjera që kanë qenë të kontraktume dhe obligime të më hershme e cila është bërë kjo shumë 66,000E. mirëmbajtja rrugore e ceka te Nebihi kjo ka qenë pjesë e mirëmbajtjes dimërore. Shërbimet për informim publik e ceku Nebihi është qështje e shërbimeve të cilat përfundohen sipas njoftimeve zyrtare të konkurseve dhe ne i kemi për obligim me i përfundu.

Karburantet është kriju një periudhë që nuk kemi mundur me përfundu shpenzimin e karburantit dhe për këtë arsye është një kosto me e lartë. Faleminderit për pyetjet.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka dikush ndonjë pyetje e mbyllim debatin për këtë pikë të rendit të ditës e cila kishte të bëjë me të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar-Mars 2024. Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/511 datë: 26.04.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës. Kemi të bëjmë me kërkesën e shpalljes së zonës me interes të përgjithshëm publik për Komunën e Malishevës dhe fillimin e procedurës për bartjen e pronësis së pronës së menaxhuar nga institucionet qendrore përkatësisht agjensioni i privatizimit, në emër të pronësis publike të komunës së Malishevës. Bëhet fjalë për 5 parcela lista poseduese për secilën prej tyre e keni para jush.

Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Unë në KPF kam kërkuar që përveq këtyre pronave të cilat janë pronë e AKP-së në një farë mënyre të cilat po tenton Komuna me i bërë prona të veta, kamë kërkuar të di a ka prona të tjera që të marrim një vendim për të gjitha pronat, mos të vijnë kështu një nga një. Të kemi një listë me të gjitha pronat të i votojmë të gjitha së bashku dhe të i përfundojmë si proces. Ne si grup i VV-së jemi për me votu këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Driton Kastrati!

**Driton Kastrati (anëtar nga LDK):** Do të kishte qenë mirë me qenë dikush nga pjesa e ekzekutivit dhe me na spjegu më mirë këtë kërkes, si do që të jetë unë isha pajtu me cilen do formë parlamentare me shty apo me votu sepse ne nuk mundemi me ja qit pikën sot se do të kalojë në faza apo hapa të tjerë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Është e drejtë e parafolësve që duhet me qenë prezent qeveria në sallë të kuvendit sepse ne mund të kemi nevojë për shpjegime më të detajizuara. Por qështja është shumë e qartë po kërkohet që këto prona të rikthehen në pronësi të Komunës, me qëllim të shfrytëzimit sa më racional qoftë për objekte qoftë për rrugë të cilat i shërbejnë këti komiteti. Ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Drejtori i gjeodezis është duke ardhur.

Urdhëro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** Zakonisht temat të cilat kanë të bëjnë me prona janë tema të ndishme duhet me i analizu shumë, sa i përket këtyre pronave, po vërehet që janë prona me rëndësi shumë të veqant dhe jetike për qytetin e Malishevës. Prandaj pronat të cilat kanë qenë në posedim të OPB Mirusha nëse arrin të kthehen në menagjim të kuvendit komunal të Malishevës besoj që i japin përparësi Komunës tonë. Edhe ne i përkrahim këto 5 parcela që të kthehen në menagjim të Komunës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Drejtori i gjeodezis, Bashkim Krasniqi. Nëse ka mundësi një prezantim të shkurtë!

**Drejtori i Gjeodezis- Bashkim Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë!

Jemi në shqyrtim të pikës së rendit të ditës në lidhje me shpalljen me interes publik të pronave të cilat janë të ish ndërmarrjes Mirusha dhe tani në menagjimin e AKP-së. Janë disa parcela të cilat i kemi pa si interes jetik për krijimin e hapsirave të nevojshme dhe dhënien e mundësis së Komunës që të investoj në këto parcela. Për momentin janë këto parcela të cilat i kemi sjellë janë afërsisht 5 është prona ku gjindet administrata e Komunës është ende nën menagjim të agjensionit Kosovar të privatizimit. Është prona ku qenë biblioteka, kryqi i kuq ku gjindet një objekt i vjetër dhe ajo është nën menaxhimin e AKP-së. Tri pronat e tjera të cilat janë të fundit në këtë kërkes janë prona që shërbejnë për hapjen e rrugës dhe zgjerimin e hapsirave rreth stacionit të autobusave. Unë e kam sqaruar dhe në KPF se ku saktësisht gjinden këto prona dhe cila është rëndësia e tyre. Po ashtu kemi marrë një sqarim nga ana e agjensionit Kosovar privatizimi që nëse Komuna ka interes për prona fillimisht duhet të shpallet me interes publik në asamble komunale, dhe pastaj të kërkohet nga institucionet qendrore që të bëhet shpronësimi i tyre. Pas shpronësimit bëhet bartja në pronësi të Komunës së Malishevës. Këto janë sqarimet nëse munda me sqaru pak më shumë në lidhje me kërkesën të cilën e kemi sjellë në asamble e cila është për shqyrtim dhe miratim.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Për këtë qështje nuk ka asnjë llojë paqartësie është një interes i joni si Komunë, pronat të cilat janë në menagjim të AKP-së të cilat nuk mundemi me i shfrytëzu dhe që po na duhet me zgjeru rrugë dhe me legalizu objektin e Komunës. Nuk ka dilema këtu sepse jemi duke i marrë pronat prej AKP-së për interesa tona.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** E hedhi në votim kush është për miratimin e kërkesës nr. 01/511 datë: 26.04.2024? me vota unanime kosnideroj që miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Me 22 anëtarë prezent.

Kalojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/528 datë: 29.04.2024, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024.

Të nderuar anëtarë nga KPF dhe Kuvendi komunal Malishevë kërkoj që të hyrat e mbetura vetanake nga viti fiskal 2023 të shqyrtohen dhe të i paraqesim kuvendit Komunal për miratim dhe bartjen në vitin fiskal 2024. Pas përfundimit të vitit 2023 mbetjet në kodin burimor 21 të të hyrave vetanake kapin shumën prej 191,422.84E e cila shumë duhet të bartet në vitin 2024.

Mjetet barten në vitin 2024 sipas tabelës më poshtë.

Urdhëro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** E shohim që trendi i rritjes së të hyrave vetanake është i mirë për Komunën tonë sepse na ofron mundësi me investu më shumë, ku shumica e të hyrave është nga sektori i ndërtimitaris ose i ekonomizmit. Në këtë rast e shoh që shumica e bartjeve të mjeteve po shkojnë te rregullimi i qendrës së sheshit në qytetin e Malishevës. Unë po mendoj që ndoshta kishte qenë më mirë që këto mjete të ridestinohen në rrugët të cilat jemi duke i shfrytëzu qdo ditë, besoj që janë në nivel jo të mirë. Dhe nevojat në rrugët lokale janë jashtëzakonisht e madhe që të riparohen, gropat dhe dëmet të cilat janë shkatuar. Propozimi im dhe i grupit është

që të ridestinohen mos të shkojnë komplet 178,296.00E në rregullimin e sheshit por të shpërndahen dhe në sektor të tjer.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Është shumë shumë e madhe 191,422.48E është prej tri kategorive planifikim mjedisor dhe inspeksioni, arsimit parafillor qerdhes dhe shëndetësia. Pajtohemi me Burimin që tha 178,296.00E është shumë e madhe nëse barten në një projekt të caktuar kur e shohim që shumë projekte të tjera kanë ngec për arsye të mungesës së mjeteve. Ndoshta kishte qenë mirë një shpërndarje e mjeteve dhe në disa projekte të tjera psh, të ndonjë rrugë lokale. Ndoshta kishte qenë mirë vetëm 100,000.00E me i nda për këtë projekt dhe 78,000E për projekte të tjera. Ky është propozimi i ynë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ka të drejtë Burimi që e cekti që rrugët lokale kryesisht në fshatra por dhe në periferi të qytetit kanë nevojë imediate që të intervenohet në ato, mirëpo sa më shumë që e zgjasim implementimin e projektit në shesh aq më shumë do të dëmtohen rrugët të tjera të cilat po i konsiderojmë që janë në rregull për qarkullim. Idea është që ato mjete të cilat janë kërkuar që të ridestinohen në projektin e sheshit dhe parkingut nën tokësor qëllimi është që punimet të kenë një intenzitet më të lartë të punës mos me qenë pengesë mjetet financiare, duke pasur parasysh kapacitetin e kompanive tona që nuk kanë ndoshta mjete të tyre me i investu në projekte pastaj në periudhat e më vonshme me i marrë mjetet nga organi kontraktues. Idea është që sa më shpejt të përfundojnë këto projekte duke krijuar hapsira që me intervencë në rrugë të tjera alternative, por patjetër që duhet me u investu dhe në rrugët në fshatra. Kërkoj nga ju që të mbështet kjo, nuk e di ku kanë mbetur këto mjetet të pa shpenzuara mirëpo neve na ka ardhur materiali vetëm ku po ridestinohen. Unë konsideroj që të pjesa e shëndetësis dhe arsimit janë të pa prekshme për arsye të grantit specifik që i ka.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Driton Kastrati!

**Driton Kastrati (anëtar nga LDK):** Trendi i ridestimitit në shesh dhe në qendër është bërë shumë i shpeshtë, analizat dhe planifikimet financiare për ndërtimin e sheshit nuk kanë qenë të duhura deri tani edhe pse ne me buxhetin fillestar është viti i dytë që po ndajmë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve për këtë projekt ato nuk po mjaftojnë kemi bërë dhe ridestitime në vitin e kaluar, po ashtu dhe bartje të mjeteve kemi bërë vitin e kaluar. Kërkesa për asfaltimin e rrugëve në fshatra në këtë buxhet do të ishte mirë mirëpo më e rëndësishme do të ishte që në fshatra të realizohen projektet të cilat kanë qenë të parapara në buxhetin me dokument fillestar. Uroj që mos me qenë devijimi shumë i madhë i planifikimit të kostos të këtyre projekteve, dhe uroj që të përfundohet më shpejt dhe të lirohet hapsira projekteve, rrugëve të tjera alternative dhe rrugëve të tjera në fshatrat e Komunës së Malishevës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

**Drejtori për Buxhet dhe Financa- Blerim Thaçi :** Qëllimi që e cekti Valoni është arsyeja që të shpejtohen procedurat e punimeve në shesh që të bëhen rrugët të tejkalueshme në qendër, dhe të zvogëlohet kostoja e kontratës të cilën e kemi të parapara për 3 vite, sepse nëse mbesum sa më

pak pages për sheshin do të mbesim obligim më shumë në vitin e ardhshëm. Nëse përfundojmë obligime më shumë ndaj kontratës dhe operatorit të cilit i përfundon punimet na lirohen hapsirat të cilat kemi pengesa në rrugët periferike të qytetit. Është dhe një gjë tjetër e ceki dhe Vetoni qështja e rrugëve tranzit ku jemi duke i shfrytëzuar ne nuk mundemi me i hedh mjetet aty sepse nuk ka kod, nuk ka planifikim dhe nuk ka kontrat për realizimin e asfalyimit të rrugës nga stacioni.

Bartja e mjeteve në kategorin e mirëmbajtjeve të rrugëve nuk e kish lehtësu shumë edhe pse kontratat e rrugëve kanë ende mjete por ne në Qërshor do ta sjellim planifikimin e të hyrave shtesë. Kisha kërkuar që këto mjete të destinohen sipas kërkesës që e kemi sjellë te ju. Pjesën tjetër që do të vjen në Qershor të planifikimi i rritjes të hyrave të i dërgojmë për kontrata të tjera që do të bëjmë një shpërndarje sipas kontratave që i kemi të nënshkuara, dhe për projekte të reja që do të fillojnë në këtë vitë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati (anëtar nga PDK):** Unë e kam një proopzim rreth këtyre ndërrim destim të këtyre mjeteve kam pasur dhe kërkesa të më hershme në projektet kapitale kisha kërkuar një pjesë të këtyre mjeteve me i bartë te një projekt në lagjen e kastartëve në Damanek një pjesë e trotuarit është shumë e nevojshme për arsye se paraqet dhe rrezik për nxënësit kur shkojnë në shkollë, duhet të ecin në rrugë kryesore për arsye të mungesës së trotuarit. Kisha propozu që të ndahet një pjesë të këtyre mjeteve për këtë trotuar.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

**Drejtori për Bugjet dhe Financa- Blerim Thaçi:** Ndrim destinim nuk është është bartje dhe nuk ekziston projekti për këtë nuk mundemi me i bartë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** E hedhi në votim kush është për miratimin e kërkesës nr. 01/528?

Për: 12

Kundër: 5

Abstenim: 3

Me 12 vota Për, 5- Kundër, 3- Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi i planit të prokurorimit për vitin 2024. Ne po jemi të vetëdijshëm që nuk mundemi me përfundu komplet seancën sot, a jeni me vazhdu? Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Meqenëse ne i kemi dy tri pika të cilat janë kërkesa të qytetarëve kisha thënë me i trajtu ato. Raportet e Komiteteteve që ju ka kalu gati koha me i përfundu këto dhe me mbajtë seancën e ardhëshme muajin tjetër.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Pika e 6 duhet të largohet nuk e kemi këtu udhëheqësin e zyrës së prokurorimit me na prezantu përderisa po kërkojnë prej sektorëve të tjer me qenë zyrtari prezent dhe me na prezantu. E kemi bërë si parim në qofitëse nuk prezantohet

një dokument i cili është pa dyshim i rëndësishëm mos të debatohet rreth ati dokumenti. Unë propozoj që pika e 6 të largohet nga rendi i ditës. Kjo që është kërkuar për shfuqizim po e përfundojmë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Propozimi i Valon Mazreku është që pika e 6 Shqyrtimi i planit të prokurorit për vitin 2024 të largohet nga rendi i ditës. Kush është për që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës?

Me vota unanime konsideroj që kjo pikë shtyhet për seancën e radhës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është Shfuqizimi i vendimit nr.02/120 datë: 29.02.2024 Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Kur është marrë vendimi për këtë pikë nëse e kujton kamë thënë që është punë e qeverisë Komunale administrimi i objekteve publike. Të njëjtën përgjigje e ka kthyer ministria e administrimit të pushtetit lokal. Nuk është kompetencë e kuvendit me marrë një vendim të tillë, për asrye të performancës dhe obligimit duhet ta shfuqizojmë këtë vendim.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është për shfuqizimin e vendimit nr.02/120? Unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesusi i Kuvendit konstaton që 20 anëtarë janë të pranishëm.

Pika e radhës është Shqyrtimi i planit të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural për mbjelljet pranverore për vitin 2024. Ftojë Drejtorin e Bujqësisë Syl Dukolli!

**Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit rural- Syl Dukolli:** Drejtoria e Bujqësisë ka planifikuar mbjelljet pranverore si zakonisht në misër, sillazh, tërshër, fasule, elb, patate, thekër, qepë etj. Të njëjtin planifikim e kemi dhe me Ministrinë e bujqësisë, ende vazhdon mbjellja që bëhet në pranverë, mbjelljet pranverore qëndrojnë shumë më mirë se ato vjeshtore. Për asrye të lëshimit të numrit të hektarëve ku sipas aplikimeve është kaluar afër 4-5 hektar jemi më mirë se në planifikim. Në drejtorinë tonë është lajm i mirë që qepa po mbillet. Jemi Komuna e dytë ose e tretë në Kosovë për kultivimin e qepës. Ne si bujqësi ne forcat e tona i kemi subvencionu 25% të farës së qepës dhe të patatës. I kemi që në implementim dhe në javët në vijim do të i marrin fermerët mjetet e 25% të farës. Në javën tjetër hapet një shpallje publike për qumësht për të gjithë ata fermerë që dorëzojnë qumësht në qumështore ku paisen me faktura, fjala është për 6 mujorshin e dytë viti 2023. E kemi një problem me ministrinë në këtë rast sepse një buxhet e kemi ai del nga qeveria, dhe dy herë subvencionohet litra e qumështit për dele dhe për dhia nuk do të ketë këtë vitë donacion. Në vitin e ardhshëm nëse më përkrahni e kam planifikimin më të madhë dhe po besoj që kemi me i përkrah dhe fermerët. Diqka tjetër nuk kamë me shtu, vetëm një gjë dua ta them që jemi duke zhvilluar biseda, takime me të gjitha shoqatat dhe organizatat të cilat veprojnë nëse ata janë në gjendje me na ndihmu edhe ne jemi në gjendje menijer me bashkëpunu dhe i kemi ndarë disa mjete të përbashkëta për bashkëfinancim për projekte me organizata të tjera.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!



**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ne të falenderojmë për raportin i inkurajojmë të gjitha ata qytetarë të cilët kanë sa do pak vullnet me u marrë me bujqësi dhe kanë kapacitet me u marrë me bujqësi dhe kërkojmë nga ju me i përkrah më shumë. Sa kamë informacion ka ardhë qarkorja e parë bugjetore ku janë përcaktuar kufit bugjetor në nivel komunal. Kërkoj që përmes të kornizës afat mesme të shpenzimeve ta kërkonim me rritë kategorin e subvencioneve për subvencionimin e bujqësis. Duke pas parasysh që këto do të shkojnë si kërkesa në kuadër të kësaj kornize në minsitrin e financave.

E përgëzoj deputetin Kastrati për iniciativën për kultivimin e qepës me atë sasi të konsiderueshme urojë që të ketë bereqet. Inkurajoj që të mirren më shumë me bujqësi sepse është fundament i ekonomisë sepse gjithë zhvillimi ekonomik ka derive si rezultat i aktiviteteve bujqësore.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo):** Në secilën sferë dhe në sferën e bujqësis kur minsitria e bujqësis është në nivel atëher edhe Drejtori sigurisht që kam me qenë në nivel.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Buqim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** Faleminderit Drejtor për planin e punës. Në këtë vitë është koha e paqëndrueshme ka reshura në vazhdimësi si është gjendja me planin operativ që ka ndodhë në teren me mbjellje të fermerëve si është gjendja në nivelin e tanishëm me bujqësi në qytetin tonë?

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Faleminderit Drejtor për angazhimin tënd që po e bënë pa u ndal për bujqësin dhe blegtorin. Bugjeti për bujqësi duhet me qenë më i madhë sepse e vetmja mundësi e zhvillimit ekonomik e Komunës tonë është përmes bujqësis. Po të premtoj që ne grupi i Nismës besoj e kemi dhe mirëkuptimin e kolegëve dhe partive të tjera politike që ato propozime dhe plane të cilat i ke për vitin e ardhëshëm ne kemi me miratuar.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor Syl Dukolli!

**Drejtori i Bujqësis, Pylltarisë dhe zhvillimit rural- Sylë Dukolli:** Realisht koha nuk është e qëndrueshme, sipas ekspertëve të cilët i kemi po konsultohemi dhe preparatet të cilat po përdoren nuk janë të nivelit të cilat po kryejn punë në herën e parë. Sa i përket gjendjes së grurit dhe misrit është e mirë, puna e pemtarisë nuk është e mirë për arsye të ndryshimit klimatik dhe ka pasë dhe breshër mirëpo kemi dalë menjher në vend të ngjarjes ekipa jonë deri në 4 nuk është kthyer. Fermeri nga Ngucati kur ju kanë dëmtuar qershit dhe të mbjellurat e tjera Amrush Helshani në momentin që ai ka bërë kërkesë ne do të shkojmë dhe do ta bëjmë llogaritjen e dëmit. Prej vitit të kaluar është një komision i formuar nga Kryeministri i qeverisë nga të gjitha ministrat. Ne i kemi dhjetë kërkesa të fermerëve të cilët kanë pas dëmtime dhe nuk kanë marrë asnjë para. Para tri jave kthehet raporti që ceket që i ke vlerësuar shumë lartë, ne i kemi bërë deklaratat së bashku me fermerët që ai dëm ka ndodhë. Mbi 100,000.00E i presin fermerët tonë me ju pagu për vitin e kaluar ndërsa këtë vitë ende nuk janë llogarit se sa janë dëmtu kamë ndërgju që nuk janë dëmet e mëdha.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** E mbylлим debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UQK-së si dhe Martirë të luftës për vitin 2023.

Urdhëro, Eqrem Morina për prezantim të këti raporti.

**Eqrem Morina (anëtar nga AAK):** Ky komitet ka mbajtur gjithësej 6 mbledhje të rregullta, ktivititetet të realizuara gjatë vitit 2023 janë: Takim me Kryetarin e invalidëve të luftës z. Fatimr Buqaj dhe Kryetarin e familjeve të martirëve të luftës Isni Kryeziu. Takimi me dy përfaqësuesit e këtyre organizatave ka qenë lidhur me informimin e gjendjes së këtyre kategorive të dalura nga lufta. Madje kemi pasur takim dhe me Kryesusin e Kuvendit z.Argjend Thaçi dhe Kryetarin e Komunës z.Ekrem Kastrati. Qëllimi i këti takimi ishte shqetësimi i anëtarëve të Komitetit lidhur me kërkesat tona që adresohen te institucionet për të cilët nuk kemi marrë përgjigjie. Nga ky raport i punës dalin këto rekomandime Për institucionet komunale që për gjdo vendim për vendosjen apo largimin e shtatorëve dhe bustëve të Dëshmorëve të Kombit, institucionet Komunale të obligohen që një gjë të till ta bëjnë në kordinim me OVL-në e UQK-së, funksionalizimin sa më parë të objektit të organizatës së dalura nga lufta, kuvendi Komunal të ndaj bugjet për mirëmbajtje të varrezave të Dëshmorëve, lapidarëve dhe memorialeve të Dëshmorëve dhe Martirëve të luftës. Miratimi i kërkesës për ndihmë financiare për familjet e dy pjestarëve të grupit të Kumanovës të cilët po mbahen në burgjet e Maqedonisë së Veriut, kërkes kjo e bërë nga Komiteti në emër të familjeve të luftëtarëve. Zhvendosjen e muzet në objektin e veteranëve pranë varrezave të dëshmorëve në Malishevë. Të kryhen të gjitha pagesat dhe mëditjet të anëtarëve të Komitetit.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UQK-së si dhe Martirë të luftës për vitin 2023?

Të pranishëm jemi 18 anëtarë.

Unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2024.

A ka dikush për diskutim? Nëse jo e hedhi në votim, kush është për miratimin e kësaj pike? Me vota unanime miratohet dhe kjo pikë e rendit të punës.

Shqyrtimi dhe miratimi i i planit të punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të luftës së UQK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024.

Urdhëro, Eqrem Morina!

**Eqrem Morina (anëtar nga AAK):** Plani i veprimit të Komitetit për familje të dëshmorëve, Invalid, Veteranë të luftës së UQK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024. Ky komitet është themeluar nga asamblea Komunale e Malishevës me qëllim të ruajtjes dhe respektimin e vlerave të luftës. Komiteti mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, mbledhjet e rregullta i mbajmë së paku 6 mbrenda vitit. Ato do të mbahen në Shkurt, Mars, Prill, Qërshor, Nëntor dhe Dhjetor. Komiteti mban objektivat dhe aktivitetet, te aktivitetet janë paraparë: Takim me organizatat të dalura nga lufta me familjar të dëshmorëve dhe martirëve. Si dhe pjesëmarrje në

akademi perkujtimore, ne organizimin e festave Kombetare siq jane 17 Shkurti, Epopeja e UQK-së, 5 6 7 Marsi, 16 Qershori dita e qlirimit të Malishevës, 28 Nëntori dhe 30 Dhjetori dita e veteranëve. Takim me Drejtor të Drejtorive dhe adresimin e kërkesave të dalura nga komiteti.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka diskutim, kush është për miratim të planit të punës së këtij komiteti? Me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesës nr.02/207, datë: 20.05.2024, kërkes për kompenzim të pronës private me pronë publike sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ligji nr.6/L-092.

Urdhëro, Halil Morina!

**Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Për këtë pikë e diskutuan në fillim Nebihi dhe Muharremi dhe i morëm pak a shumë sqarimet e duhura, meqë është vendim gjyqësor dhe jemi të obliguar me kompenzu, është mirë me ja dhënë dritën jeshile. Nuk po këmbejm po e inicojmë atë punë, vlerësimin e bën ministria e financave i ka 3-4 prona ku mundet me u kompenzu. Bëhet vlerësimi në Ministrinë e financave vjenë këtu prap dhe ne e marrim vendimin. Me lënë për muajin tjetër këtë qështje është në dëm tonin sepse me fitu me përmbarues na merr pronën ku neve ndoshta nuk na konvenon. Më mirë është me ja fillu procedurës.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Kamë ndëgjju që kjo zona këtu prej rrugës përball markët Beharit e deri te pompa kanë qenë prona private. Ndoshta si rezultat i kësaj ka ardhë ky vendim gjyqësor shumica e atyre pronarëve i kanë marrë ato prona me vendime gjyqësore, është ligj i gjykatës ne nuk jemi këtu me konstatu ligjshmërin apo aftësin e tyre.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Arlind Morina!

**Arlind Morina (anëtar nga LDK):** Edhe unë jamë që kjo pikë të përfundohet sot Muharremi i dha sqarimet e tij nuk kemi pse ta vonojmë këtë procedur ne jemi pro e kësaj pike.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** Qështja e pronave është tem me rëndësi të veqant. Në cilën do formë që e trajtojmë pronën është mirë që ta analizojmë mirë mos të bëjmë veprime të gutshme që në të ardhmëm me i kushtui dhe qytetarëve të Malishevës. Këtu është një propozim me kompenzu pronën private me pronat publike që janë me pronësi të kuvendit Komunal të Malishevës. Unë dua një sqarim më të madh nga Drejtori për gjeodëzi i cili nuk është këtu, sepse totali i metrave katrore për arsye të aktgjykimit z.Hazir Tredhaku i ka 2254 1m<sup>2</sup> me pjesën e propozuar që janë 12 parcella i bie 26692m<sup>2</sup>. Duhet të analizohet shumë mirë, a kanë me u dhënë këto 12 parcella apo si ka me shku kjo formë kisha kërkuar një sqarim më të mirë edhe pse unë dhe grupi im jemi kundër kësaj. Unë kisha propozu me shty për seancën e radhës sepse e kshim analizu më shumë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Hamit Lima!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Qështjen e këtyre pronave e kemi diskutuar në KPF dhe pasi që është Muharremi këtu na sqaron ndërtimi te shtëpia e shëndetit ka ndodhur shumë vonë a ka qenë në proces gjyqësor këto parcela para se me fillu ndërtimi? Nëse kanë qenë në proces gjyqësor përse keni fillu me ndërtime? Nuk mundemi për 25 ari me ja kompenzu 2 hektar.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Nuk po mundemi me kuptu këtë mënyrën e kompenzimit sepse nuk është kështu Muharremi ndoshta na sqaron më mirë. Urdhëro, Muharrem Morina!

**Muharrem Morina (Zyrtar ligjor i Kuvendit):** Nëse i referoheni shkresës së palës, pala ka hyrë në posedim juridik të parcelës e ka fitu të drejtë me pas pronësi mbi atë pjesë. në atë pjesë i kanë fitu rastet të gjithë Malishevasit që i kanë pas pronat në kohët e më parshme. Është e fundit ky që e ka fitu rastin në atë pjesë ku ai ka pasur bazë juridike bazë ligjore me fitu rastin për arsye se të parët e tyre kanë pasur pronat aty. Sa i përket shtëpia e shëndetit është ndërtu para lufte ato kanë qenë pjesë e komepartivës mirëpo është marrë vendim në Komunë që pronat me ju marrë Kooperativës me i vendos në kuvendin Komunal. Fillimisht e kanë padit AKP-në kur i ka vendos Komuna mbi vete për arsye se ka qenë ambullanta aty e ka shfrytëzu për interes publik, pastaj prona është tërhek prej ndjekjes me padi të AKP-së dhe i është drejtu Komunës. Në këtë procedur i ken fitu rastet edhe më herët dhe këtë rast mund të ndodhë dhe raste të tjera për arsye se historiati i pronësis është private koha kur e kanë marrë e kan shfrytëzu për qëllime të kooperativës është një koh 50-60 vite por pronarët privat i kanë ruajt për arsye të tapive të tyre që i kanë pas. Keni parasysh që pala ka kërku me këmbi për arsye se është hymja e oborrit të ambullantës, për mos me i pengu shërbimeve publike ai po kërkon me hy me këmbim. Propozimi i palës nëse votohet vjen në pyetje propozimi i Kryetarit, nëse ju e votoni me ja marrë atë parcelë me bërë zonë me interes të përgjithshëm publik për qëllim të shtëpis së shëndetit, pastaj Kryetari i ka ofru pronat publike të cilat janë të lira për këmbim.

Kryetari nuk ka thënë që ja dhëjmë 2 hektar, por ka thënë që këto prona publike janë të lira dhe ju keni me vendos për këto prona me i shti në proces të këmbimit. Pastaj Ministria e pushtetit lokal ka me vërtetu procedurën ligjore a kena vepru ne drejtë apo jo, ka me u kthy lënda te ne prapë ne kemi me dërgu në Ministri të financave me bërë vlerësim të pronës të cilën kemi me bërë me procedur zonë me interes të përgjithshëm publik, pronën private kemi me bërë publike. Ka me bërë vlerësimin e vetë financiar për të gjitha pronat që i ofrojmë për kompenzim, vlera ka me u barazu me vlerë financiare ka mundësi 1 me 2 ka mundësi 2/2 por 1/10 nuk ka mundësi. Por keni parasysh që ka dallim shumë të madh pronën të cilën kemi me marrë me pronat të cilat i ofrojmë ne. Kjo vjenë prap te ju dhe keni me parë qfarë vlersimi i kanë bërë, pastaj ju keni me vendos a me leju këmbimin apo jo.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Këtu është 99% interesi i Komunës dhe 1% interesi i palës sepse ajo parcelë në aktgjykim ka dalë që është e palës, ne nuk mundemi me kontestu vendimin e gjykatës idea është me i dhënë zgjidhje që mos me u blloku ai institucion publik. Ndërmarrjet shoqërore që kanë qenë me ish systemin në atë kohë statute i tyre gjithmon i ka parapa që 20% të aksionarëve janë vetë puntorët e ndërmarrjes dhe për këtë arsye 20% të cilën ka me ja pagu Komuna është për këtë arsye. Unë kërkoj të i dhëjmë epilog kësaj pune sepse është në interes të Komunës sepse shumë më me vlerë është ajo pjesë aty.

punësimin kështu që nuk ka asnjë pengesë që na mos me votu pro. Në emër të grupit ne votojmë pro kësaj kërkesë.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Muharremi e sqaroi por ne si anëtarë të kuvendit nuk e dim a është në kundërshtim me planin zhvillimor Komunal. Trajtimi i këtyre rasteve në kuvend është që duhet të nxirret vendimi nga legjislatura e vitit të kaluar i cili ka qenë vendim i pa logjikshëm. Ne e kemi miratuar planin zhvillimor Komunal, plani zhvillimor është dokument strategjik ne nuk e dimë a e pengon këtë plan. Unë jam pro secilit biznes që hapet dhe qka do që kemi mundësi si institucion me i përkrah mirëpo proceduralisht është dashur që këti dokumenti me ju bashkëgjithë një vërtetim nga Drejtoria e Urbanizmit që na konfirmon neve që kjo parcelë është konform planit zhvillimor, nuk e pengon planin zhvillimor Komunal. Unë propozoj Kryesus në mbledhjen e ardhëshme me sjellë shfuqizimin e atij vendimi, mos të marrim vendim që nuk është kompetencë e jona. Sidoqoftë jamë pro e këti pëlqimi sepse janë dhe instancat e tjera të cilat kanë me i verifikuar të gjitha.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi (anëtar nga PDK):** Unë së pari dua të i falenderoj bashëkëndasit e mi për një iniciativë të tillë që me fillu dhe me zhvillu një biznes të ri nga i cili do të ketë dhe punësime të reja qka është e mirë dhe për fshatin Dragobil. Sa i përket këti pëlqimi parcella apo zona ku do të ndërtohet betonjerka është në zonën kadastrale Dragobil qka nuk i pengon dhe planin zhvillimor, momentalisht nuk ka diçka që mundet me pengu zhvillimin e qytetit. Mirë e ka Valoni ato vendimet të cilat janë marrë në asamble në vitin 2019 është mirë me u shfuqizu që Drejtoria e Urbanizmit të lëshoj një pëlqim të caktuar që mos të shkaktoj te qytetarët vonesa në procedurë. Për arsye se pëlqimet kryesore apo ankesat i jep ministria e planifikimit ne sot vetëm pëlqimin e japim këtu.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo):** Unë këtë kërkesë e kam shqyrtuar me vëmendje sepse është nga mërgimtarët tanë dhe është nder dhe krenari që kërkesa të tilla vijë në kuvend. Mërgimtarët të cilët fitimin e tyre material e financiar shprehin dëshirën të investojnë në atdheun e tyre. Prandaj vota ime do të jetë pro.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Unë mendoj që kjo hapje e biznesit është një shembull i mirë që nga ky biznes të krijohen vende të reja të punës dhe më vjen mirë që këta mërgimtarë janë të gatshëm për të kontribuar në vendlindjen e tyre. Kësaj familje i dëshiroj suksese në hapjen e këti biznesi.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/203?

Për: 15

Kundër: 3

Abstenim: 0

Me 15 vota Për, 3- Kundër, 0- Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/179, datë: 19.04.2024. Për marrjen e pëlqimit për ri përkufizimin e kufive të parcelës në të cilën është i ndërtuar objekti afarizëm dhe banim shfrytëzuesi i të cilës është organizata e pensionistëve. Urdhëro, Muharrem Morina për sqarim më të hollësishëm.

**Muharrem Morina (Zyrtar ligjor i Kuvendit):** Edhe kërkesa në fjalë që është parashtru është trajtu në KPF flitet për shtëpin e pensionistave e cila është ndërtu me kompenzim në marrveshje që është lidh në vitin 2011 me ish Kryetarin në bazë të vendimit të asambles që ju ka leju një sipërfaqe me 5 ari. Pasatj Kryetari ju ka leju me gjetë donatorin me ndërtu me kompenzim, për arsye se bazamenti i ndërtimit është mbrenda zonës prej 5 ari ndërsa kur është ndërtu objekti me ballkona ka dalë jashta zonës kadastrale. Tash kërkohet me u ripërkufizu, sipërfaqja nuk ndryshon por ndryshon ripërkufizimi për arsye se objekti në fjalë me u regjistru në kadastër që me nda investitori dhe organizata e pensionistave duhet me u legalizu. Për me u legalizu duhet të bëhet ripërkufizim komplet me hy brenda zonës së ndërtimit, pastaj me u bë ndarja e pasuris në bazë të marrveshjes që e keni 25 me 75%. Është vërtetu edhe nga Drejtori i gjeodezis që prona për rreth nuk janë private, nuk e pengon askënd është pronë publike, sipërfaqja nuk ndryshon.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate):** Ndoshta nuk kemi mundur me u konsultu mjaftueshëm për materialin dhe me i largu të gjitha ato dyshimet unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhëshme.

**Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:** Kush është që pikat e mbetura të barten për mbledhjen e rregullt të ardhëshme. Nga 20 të pranishëm me vota unanime pikat e mbetura barten në mbledhjen e ardhshme.

Faleminderit për kontributin e juaj e mbylli seancën.

Procesmbajtësja:  
Argenitë Krasniqi

---

